



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

RAPORT

MBI GJETJET E MONITORIMIT TË PËRDORIMIT TË SALLAVE TË GJYQIT DHE SISTEMIT TË REGJISTRIMIT DIGJITAL AUDIO NË GJYKATA



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

RAPORT
MBI GJETJET E MONITORIMIT TË PËRDORIMIT TË SALLAVE TË GJYQIT DHE
SISTEMIT TË REGJISTRIMIT DIGJITAL AUDIO NË GJYKATA

Nisma “Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri”

Gusht 2017

Raporti u realizua me mbështetjen e Projektit të USAID-it “Drejtësi për të Gjithë”. Brendia e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Përgatitën:

1. Av. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive e KShH-së
2. Nevila Zyma, informaticiene

Asistoi:

1. Valmira Kallushi, Menaxhere Projektesh

Dizajn:

uzinaliquida

Printim:

Intergrafika

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-te, Pallati "Tekno Projekt"
Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671
Cel: 0694075732
E-mail: office@ahc.org.al;
web site: www.ahc.org.al

Hyrje

Të dashur lexues,

Gjyqësori përbën pushtetin e tretë të sistemit të qeverisjes në vendin tonë. Për qytetarët, gjyqësori është pushteti më i rëndësishëm që garanton zbatimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të tyre.

Publiciteti i seancës gjyqësore është një nga aspektet më të rëndësishme të së drejtës për proces të rregullt, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjithashtu, zbatimi i sistemit të regjistrimit digjital audio në gjykata përbën një kërkesë të detyrueshme ligjore, çka garanton saktësi të nivelit të lartë të dokumentimit të seancës gjyqësore dhe rrit transparencën, efikasitetin si dhe përmirëson administrimin e gjykatave.

Gjatë periudhës Nëntor 2016 – Qershor 2017, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), me mbështetjen e Projektit të USAID-it “Drejtësi për të gjithë” zbatoi nismën “Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri”. Synimi i kësaj nisme ishte vlerësimi i përdorimit të sallave të gjyqit dhe i sistemit të regjistrimit digjital audio në të gjitha gjykatat e të tria niveleve në Shqipëri. Për të realizuar këtë vlerësim, gjatë muajve janar, shkurt dhe mars të vitit 2017, KSHH monitoroi një numër të lartë seancash gjyqësore, për të parë nivelin e përdorimit të sallave të gjyqit, mënyrën se si kryhet regjistrimi audio i seancave dhe si udhëzohen palët dhe pjesëmarrësit në gjykim nga personeli gjyqësor gjatë zhvillimit të seancës. Gjithashtu, KSHH realizoi intervista me personelin dhe përdoruesit e gjykatave. Procesi i monitorimit dhe intervistave u realizua paralelisht në të 38-të gjykatat e vendit.

Ky raport është një përmbledhje që vjen pas përpunimit të të gjitha të dhënave të mbledhura gjatë procesit të monitorimit dhe intervistat e realizuara me personat dhe palët në procese, si dhe me vetë stafin e gjykatave. Raporti përmban gjetje të përgjithshme në nivel makro si dhe gjetje në nivel mikro të grupuara sipas gjykatave, me qëllim që çdo gjykatë të ketë mundësi të vlerësojë vështirësitë dhe mundësitë për përdorimin sa më efikas të sallave të gjyqit dhe sistemit të regjistrimit audio.

Draft raporti është konsultuar fillimisht në tryezën e datës 15 Maj 2017, ku morën pjesë të gjitha gjykatat e monitoruara, me prezencën e një pjesë të kryetarëve, kancelarëve dhe stafit IT të këtyre gjykatave. Me anë të kësaj tryeze u nxit diskutimi aktiv mes pjesëmarrësve për gjetjet e raportit. Falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit aktivë të kësaj tryeze, të cilët kontribuuan me sugjerime të vlefshme, të cilat përmirësojnë gjetjet dhe rekomandimet e shpalosura në këtë raport monitorimi. Gjithashtu, falënderojmë znj. Joana Qeleshi, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, z. Roland Jaupaj, Kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, znj. Ornela Naqellari, Kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe znj. Alma Licaj, Kryetare e Gjykatës së Apelit Vlorë për kontributet me shkrim që kanë përcjellë dhe që kanë gjetur reflektim në këtë raport. Para publikimit të tij, draft raporti iu dërgua të gjitha gjykatave për të marrë mendimet e tyre.

Me anë të këtij raporti dëshirojmë t’u vijmë në ndihmë gjykatave me qëllim që të përmirësojnë problematikat e evidentuara. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti i paraqiten edhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë të Drejtësisë dhe Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, duke shpresuar në hartimin e politikave dhe strategjive apo mbështetjen financiare për kapërcimin e vështirësive që hasin gjykatat, me qëllimin final për përdorimin 100% të sallave të gjyqit dhe të sistemit të regjistrimit audio. Këto gjetje vlerësojmë se do t’i shërbejnë planifikimit më të mirë strategjik nga vetë gjykatat si dhe përmirësimit të administrimit gjyqësor, çka do të ndikojë në rritjen e mëtejshme të besimit të qytetarëve tek gjykatat dhe sistemi i drejtësisë në tërësi.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti janë strukturuar në shtatë kapituj. Konkretisht:

- a) Kapitulli i parë trajton kuadrin ligjor që normon çështjet që kanë qenë objekt i këtij monitorimi.
- b) Kapitulli i dytë shpjegon metodologjinë e përdorur për kryerjen e monitorimit.
- c) Kapitujt III - V paraqesin gjetjet përkatëse për përdorimin e sallave, të regjistrimit digjital audio si dhe për marrjen e kopjeve të CD-së apo transkriptimin e procesverbalit të mbajtur me mjetet e regjistrimit audio.
- d) Në mbyllje dy Kapitujt e fundit përmbledhin gjetjet dhe japin rekomandime për hapat që duhen marrë për të tejkaluar vështirësitë përkatëse.
- e) Raporti përmban edhe shtatë shtojca, ku pasqyrohen pyetësorët me anë të të cilëve është kryer monitorimi/intervistat si dhe informacion më i detajuar lidhur me kuadrin ligjor, metodologjinë e monitorimit si dhe të dhënat sasiore për çdo gjykatë të monitoruar.

KSHH dëshiron të falënderojë të gjithë personelin, kancelarët, gjyqtarët dhe kryetarët e gjykatave për bashkëpunimin, krijimin e lehtësive të nevojshme për realizimin e këtij monitorimi si dhe gatishmërinë e tyre për të dhënë informacionin e kërkuar në kuadër të nismës. Gjithashtu, një falënderim i shkon edhe të gjithë monitoruesve të përfshirë në këtë raport monitorimi, koordinatorëve rajonalë të organizatës “Intelektualet e Rinj Shpresë” në Shkodër dhe “Epoka e Re” në Fier, pa angazhimin dhe kontributin profesional të të cilëve, intervistat dhe monitorimet nuk do të ishin të mundura.

Një vlerësim të madh dhe të sinqertë i rezervojmë Projektit të USAID-it Drejtësi për të Gjithë, i cili mbështeti financiarisht këtë nismë dhe udhëhoqi punën e stafit të KShH-së për përmbushjen e aktiviteteve dhe objektivave të kësaj nisme gjatë gjithë këtyre muajve.

Sinqerisht,

Erida Skëndaj


**Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Përmbajtja

Kapitulli I.....	8
Kuadri Ligjor.....	8
Kapitulli II.....	10
Metodologjia.....	10
Kapitulli III.....	13
Përdorimi i sallave të gjyqit.....	13
Kapitulli IV.....	21
Përdorimi i sistemit të regjistrimit digjital audio (RDA).....	21
Kapitulli V.....	40
Marrja e kopjeve të regjistrimit audio dhe transkriptimet.....	40
Kapitulli VI.....	48
Vlerësimet dhe sugjerimet e stafit dhe përdoruesve të gjykatës për RDA.....	48
Kapitulli VII.....	51
Përfundime.....	51
Kapitulli VIII.....	55
Rekomandime.....	55
Shtojcat.....	58

Kapitulli I

Kuadri Ligjor



Publiciteti i seancës gjyqësore është parim i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ky parim duhet të respektohet, me përjashtim të rasteve të përcaktuara nga neni 340 i Kodit të Procedurës Penale dhe neni 172 i Kodit të Procedurës Civile, kur seancat gjyqësore mund të bëhen të mbyllura. Për të garantuar maksimalisht publicitetin, kërkohet që seancat gjyqësore të zhvillohen në sallat e gjyqit. Përdorimi i sallave të gjyqit parashikohet edhe në vendimin nr. 238/1/b, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit” ku thuhet se të gjitha proceset gjyqësore, për sa është e mundur, duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete.

Përdorimi i sistemit të regjistrimit digjital audio është i rregulluar si në Kodin e Procedurës Civile dhe në atë Penale. Kështu neni 118 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance. Më tej, ky nen përcakton se vetëm nëse nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim. Në të njëjtin nen në vijim parashikohet se *“Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja”*. Kodi i Procedurës Civile gjithashtu përmban dispozita për transkriptimin e procesverbaleve të mbajtura nëpërmjet regjistrimit audio në nenin 119 të tij si dhe për marrjen e kopjes së regjistrimit.

Në kuadër të Reformës në Drejtësi, Kuvendi i Shqipërisë miratoi me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017 disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale. Sipas këtyre ndryshimeve, u rregullua në mënyrë më të qartë e të plotë dokumentimi i procesverbalit me regjistrimin audio si dhe transkriptimi i tij. Përkatësisht në nenin 115 të Kodit të Procedurës Penale parashikohet ndër të tjerash se: *“1. Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore. 2. Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues. 3. Kur nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim, nën mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues. ...”*. Gjithashtu “Neni 116 parashikon se *“1. Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive bëhet nga sekretari gjyqësor ose nën mbikëqyrjen e tij nga teknikë të caktuar nga gjykata për këtë qëllim, duke treguar në mënyrë të saktë të gjithë përmbajtjen e regjistrimit. ...”*.

Përsa i përket mbajtjes së procesverbalit nëpërmjet regjistrimit audio në çështjet penale rëndësi të veçantë përbën vendimi unifikues Penal Nr.2 i datës 27.04.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili në paragrafin 40 të tij sqaron se *“Në përgjigje të pyetjes së shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, efikasitetin dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.”*


Dispozita përkatëse i gjejmë edhe ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në nenin 34 ku përcaktohet se seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj.

Rregulla të hollësishme për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio parashikohen në Udhëzimin nr. 353, datë 3.9.2013 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”. Edhe pse ky Udhëzim në nenin 2 të tij përcakton se “mjetet digjitale audio të regjistrimit të seancave gjyqësore përdoren për regjistrimin e seancave gjyqësore të gjykimeve civile, administrative dhe penale, të zhvilluara në ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë” dhe nuk përmend Gjykatën e Lartë, sipas intervistave me stafin dhe kryetarin e Gjykatës, ajo e zbaton me rigorozitet këtë udhëzim dhe kuadrin ligjor përkatës. Në të njëjtin udhëzim parashikohen edhe rregullime përkatëse përsa i përket marrjes së kopjeve të regjistrimit me mjete audio dhe transkriptimit

Përveç këtyre vlejné për t’u përmendur edhe: Urdhri nr. 358, datë 5.9.2013 i Ministrit të Drejtësisë “Për tarifat e transkriptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur me mjete të regjistrimit audio ose audioviziv”, Urdhri Nr. 359, datë 5.9.2013 i Ministrit të Drejtësisë “Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance” (shih Shtojcën 1 “Kuadri ligjor për mbajtjen e procesverbalit me mjete audio dhe për përdorimin e sallave të gjyqit”).

Kapitulli II

Metodologjia



Për të vlerësuar përdorimin e sallave të gjyqit dhe të sistemit të regjistrimit digjital audio (RDA), monitorimi i kryer është bazuar në një metodologji të veçantë. Metodologjia u hartua duke u mbështetur në një evidencë fillestare të dhënash të gjeneruar nëpërmjet programit PAKS+. Evidenca u mbështet në raporte të gjeneruara nga PAKS+ për periudhën Shtator 2015 - Qershor 2016, i cili përmbante informacion statistikor mbi numrin e gjyqtarëve në çdo gjykatë, numrin e sallave të gjyqit dhe përqindjen e përdorimit të sistemit të regjistrimit digjital audio në Shtator të vitit 2015, periudhë që përkonte me përfundimin e shtrirjes së sistemit RDA në të gjitha gjykatat shqiptare nga projekti i mëparshëm i USAID-it "Për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri JuST". Gjithashtu, evidenca pasqyronte informacion mbi numrin e seancave të regjistruara në audio, numrin e të gjithë seancave të mbajtura dhe përqindjen e përdorimit të sistemit RDA deri në muajin Qershor të vitit 2016.

Kjo evidencë tregoi se për periudhën nga shtatori 2015 deri në qershor 2016, përkatësisht 28.9% e gjykatave kishin arritur të regjistronin 100 % të seancave gjyqësore. Këto ishin gjykatat e apelit Shkodër, Tiranë, Durrës, Korçë, Vlorë e Gjirokastrë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, si dhe gjykatat e rretheve gjyqësore Korçë, Kukës, Gjirokastrë dhe Përmet. Nga ana tjetër, gjykata të tjera kishin përqindje më të ulët. Kështu, 42% e gjykatave kishin një përqindje midis 13 dhe 90 % të regjistrimit audio. Mbi 90% të seancave të regjistruara me audio ishin në gjykatat e rretheve gjyqësore Sarandë, Pogradec, Dibër, Vlorë, Lezhë, Krujë, Mat, Lushnjë dhe Pukë. Informacioni fillestar tregoi se gjykatat në të cilat përqindja e regjistrimit të seancave me sistemin audio nuk ishte në nivele maksimale ishin ato të rretheve gjyqësore Elbasan, Tiranë, Durrës, Tropojë, Shkodër, Kurbin, Fier, Berat, Kavajë dhe gjykatat administrative të shkallës së parë të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Korçës, Vlorës së bashku me Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (shih tabelën përkatëse në *Shtojcën nr. 2 "Përqindja e Përdorimit të Sistemit RDA në qershor 2016"*). Këto gjetje shërbyen për të patur disa të dhëna fillestare për përdorimin e sistemit audio, si dhe për të përgatitur një metodologji të kujdesshme për monitorimin në kuadër të nismës "Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri".

Qëllimi i këtij monitorimi tepër dinamik dhe intensiv që për herë të parë u shtri në të gjitha gjykatat e vendit ishte evidentimi i të dhënave sasiore dhe cilësore mbi përdorimin e sallave të gjyqit dhe sistemit RDA. Për të realizuar këtë nismë u hartua një grafik i detajuar monitorimi me datat përkatëse për secilën gjykatë dhe metodologjia e realizimit të çdo monitorimi dhe interviste. Me qëllim marrjen e një informacioni nga burime të ndryshme dhe ballafaqimin e tij, monitorimi u shtri në tre drejtime kryesore, ku për secilin drejtim u përgatit një metodologji e veçantë. Përkatësisht u monitoruan seancat gjyqësore (drejtimi i parë), u realizuan intervista me përdoruesit e gjykatave (drejtimi i dytë) dhe u realizuan intervista me stafin e gjykatave (drejtimi i tretë). Për të tria metodologjitë, u hartuan formularët dhe pyetësorët të cilët shërbyen si mjete për të marrë informacion cilësor dhe sasior (shih Shtojcat 3 "Formularët 1-6"). Këto pyetësorë më pas u përshtatën në një databazë elektronike online, e cila mundësonte hedhjen e tyre në mënyrë individuale nga çdo vëzhgues dhe përpunimin e një pjesë të të dhënave në mënyrë automatike.

Për të realizuar misionin monitorues dhe intervistat, KSHH realizoi një trajnim për ngritjen e kapaciteteve të vëzhguesve të përzgjedhur. Një pjesë e vëzhguesve u përzgjedhën në sajë të bashkëpunimit të vendosur me universitete të ndryshme në vend (Universiteti "Fan Noli" në Korçë, "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë, "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan, "Luigj Gurakuqi" në Shkodër dhe Fakulteti i Drejtësisë në Universitetin e Tiranës). Vëzhguesit u shpërndanë sipas grafikut në të 38 gjykatat, në një hark kohor prej 2 muaj e gjysmë. Çdo monitorues shpenzoi tre ose katër ditë të njëpasnjëshme në çdo gjykatë, përgjatë orarit të punës në gjykatën në fjalë. Në dy- tri ditët e para çdo monitorues vëzhgoi seancat, ndërsa në ditën në vazhdim, realizoi intervista me përdoruesit e gjykatave. E njëjta procedurë u përsërit në krye të tre javëve në çdo gjykatë. Procesi i monitorimit u fragmentua në masa


kohore proporcionale për të arritur të dhëna sa më objektive, të pandikuara nga prezenca e zgjatur e vëzhguesve. Të gjithë proceset e monitorimit u realizuan në periudhën 15 Janar- 30 Mars 2017.

Gjatë periudhës së monitorimit u vëzhguan 5437 seanca gjyqësore¹, u pyetën 4929 përdorues gjykatash (shih Shtojcën 4 “Volumi i seancave të monitoruara dhe i intervistave të kryera në secilën gjykatë”) dhe u intervistuan të gjithë kryetarët, kancelarët, punonjësit IT dhe 37% të sekretarëve gjyqësorë në të 38 gjykatat e vendit.

Përsa i përket intervistave me përdoruesit e gjykatave, monitoruesit u pajisën me kopje të pyetësorit dhe realizuan intervista direkte lidhur me përdorimin e sallave të gjyqit, sistemin RDA dhe aksesin në marrjen e kopjeve të regjistrimit audio të seancave. Me anë të këtyre intervistave, monitoruesit u njohën me përvojën dhe përshtypjet e përdoruesve të gjykatave lidhur me këto aspekte (shih *Shtojcën nr. 3*).


Gjatë procesit të monitorimit të seancave gjyqësore u vëzhguan çështje të shumëllojshme, civile, familjare, tregtare, penale dhe administrative qofshin këto me dy palë kundërshtare apo me një palë. Vëllimi i seancave të monitoruara për secilën nga çështjet pasqyrohet në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku nr. 1 – Vëllimi i çështjeve të monitoruara sipas natyrës së tyre



Intervistat me palët dhe përdoruesit e gjykatave u realizuan në ambientet e gjykatave. Të intervistuarit ishin avokatë, prokurorë, ekspertë, palë ndërgjygjëse, dëshmitarë, etj. (shih grafikun nr.2 në vijim). 60% e të intervistuarve ishin të gjinisë mashkullore dhe 40% të asaj femërore. Monitoruesit patën vështirësi të intervistonin personat e ndodhur në ambientet e gjykatave, në mënyrë të veçantë në gjykatat e krimeve të rënda, për shkak mbase të natyrës së çështjeve në këtë gjykatë.

¹ Për 2 prej formularëve nuk mund të nxirren përfundime për shkak të mungesës së informacionit së plotë në to.

Grafiku nr. 2 - Kategorizimi i të intervistuarve (përdoruesve të gjykatave)


Në përfundim të periudhës së monitorimit u realizuan takime dhe intervista me të gjithë kryetarët e gjykatave, kancelarët, e personelin IT dhe 37% të sekretarëve gjyqësor. Pyetjet e adresuara gjatë këtyre intervistave synonin marrjen e informacionit dhe sugjerimeve nga të intervistuarit mbi përdorimin e sallave të gjyqit, të sistemit RDA dhe aksesit për marrjen e kopjeve të certifikuara të origjinalit të regjistrimeve audio si dhe transkripteve të tyre.

Përgjigjet e marra nga të gjithë personat e intervistuar dhe informacionet e siguruar nëpërmjet monitorimit të seancave gjyqësore janë analizuar dhe përpunuar në mënyrë të kujdesshme dhe paraqiten në këtë raport në formë të përmbledhur.

Gjetjet e kryesore të këtij raporti tregojnë përqindjen e përdorimit të sallave të gjyqit dhe sistemit të regjistrimit digjital audio në të gjitha gjykatat e vendit. Ato tregojnë një kuadër të lartë të përdorimit. Megjithatë, shpresojmë që disa nga gjetjet e këtij raporti të ndihmojnë institucionet përgjegjëse dhe gjykatat shqiptare në zgjidhjen e problematikave përkatëse sidomos në lidhje me infrastrukturën e sallave të gjyqit, nivelin e përdorimit të tyre si dhe përmirësimin e përdorimit të sistemit të regjistrimit digjital audio, në mënyrë që të gjitha seancat gjyqësore të mbahen në sala gjyqi dhe të dokumentohen nëpërmjet regjistrimit digjital audio.

Kapitulli III

Përdorimi i sallave të gjyqit



Në secilën prej gjykatave nga monitoruesit u evidentua numri i sallave të gjyqit në përdorim gjatë kryerjes së procesit të monitorimit. Gjithashtu, u pyetën palët dhe përdoruesit e ndodhur në ambientet e gjykatës, në lidhje me përvojën e tyre për përdorimin e sallave. Gjithashtu, u mor informacion për përdorimin e tyre nga stafi i gjykatës, si kancelari, punonjësi IT dhe sekretaria gjyqësore, por edhe kryetari i gjykatës.

3.1 Të dhëna për kapacitetin e sallave të gjyqit dhe përdorimin e tyre

Monitoruesit raportuan se gjatë kryerjes së vëzhgimit të gjitha sallat e gjyqit ishin në përdorim, pra në to po zhvilloheshin seanca gjyqësore. Të dhënat e raportuara në shkallë vendi, nga vëzhguesit evidentojnë se shumica (93%) e seancave të monitoruara u zhvilluan në salla gjyqi. Vetëm afro 7% e tyre (372 nga 5437) nuk u zhvillua në salla gjykimi.


Përsa u përket seancave të cilat nuk u zhvilluan në sallat e gjyqit (7% e totalit), përkatësisht 29% e tyre ose 107 seanca në total nuk u zhvilluan në salla gjyqi për shkak se nuk kishte salla të lira. Mungesa e sallave u vu re veçanërisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku për 49 seanca (4.2 %), prej totalit të seancave të monitoruara në këtë gjykatë nuk kishte sallë gjyqi të lirë. I njëjti problem u vu re edhe në gjykatat e rretheve gjyqësore Shkodër (24 seanca ose 6.6%), Elbasan (19 seanca ose 7.8%). Në numër më të ulët, zhvillimi i seancave gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve për shkak të mungesës së sallave të gjyqit u vu re në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (3 ose 1%) dhe Berat (2 ose 1.6%), si dhe në gjykatat administrative të shkallës së parë Vlorë (4 ose 2.94%), Tiranë (2 ose 0.54%), Durrës (1 ose 1.33%) dhe Korçë (1 ose 0.95% si dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër (1 seancë ose 1.56%) dhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda (1 seancë ose 4.54%).

Të dhënat e raportuara evidentojnë një numër mjaft të ulët të palëve që gjatë seancave u ankuan për moszhvillimin e seancës gjyqësore në sallën e gjyqit. Në shkallë vendi kjo ka ndodhur vetëm në 0,2% (13 nga rreth 5437) të seancave gjyqësore të monitoruara. Në disa prej këtyre rasteve, palët janë ankuar sepse për shkak të mungesës së energjisë gjykimi zhvillohej në zyra. Në një prej rasteve, avokatja madje dhe vetë gjyqtarja e çështjes theksuan se zhvillimi i seancave civile në zyrën e tyre ishte e vështirë dhe se do të ishte më e përshtatshme nëse ato do të mbaheshin në sallë gjyqi, pamundësi kjo për shkak se sallat ekzistuese përdoren vetëm për gjykimet penale.

Gjithashtu, vëzhguesit monitoruan nëse kishte përjashtim të të pranishmëve në seancë për shkak të zhvillimit të gjyqit në zyrë. Nga monitoruesit u raportua një numër tejet i vogël i seancave të vëzhguara, përkatësisht 2% e tyre, ku pjesëmarrësit janë detyruar të largohen nga zyra e gjyqtarit/es për shkak të mungesës së hapësirës. Në 1% të seancave të monitoruara, mungesa e hapësirës ka çuar në zhvillimin e saj me prezencën e palëve/publikut në kushte të vështira. Në 95% të seancave të monitoruara nuk raportohen problematika apo vështirësi për pjesëmarrjen e palëve/publikut në seancën e zhvilluar në zyrën e gjyqtarit. Këto gjetje paraqiten në grafikun në vijim.

Grafiku nr. 3 – Pjesëmarrja e palëve/publikut në seancat e zhvilluara në zyrë


Nëse seanca zhvillohet në zyrë,
a janë përjashtuar disa nga të pranishmit?



Të pyetur për përdorimin e sallave të gjykimit, vetëm në 9% të rasteve, përdoruesit/palët e intervistuar janë përgjigjur se ndërkohë që seanca është mbajtur në zyrën e gjyqtarit, sala e gjykimit në gjykatën përkatëse ishte e lirë. Këto gjetje paraqiten në grafikun në vijim:


Grafiku nr. 4 – Të dhëna për intervistat me palët/përdoruesit e gjykatave lidhur me përdorimin e sallave të gjykimit

A keni qënë ndonjëherë prezent
në një seancë në zyrë ndërkohë
që sala e gjykimit nuk po përdorej?




Qytetarët seancat e të cilëve janë zhvilluar në zyrat e gjyqtarëve janë pyetur se sipas dijenisë së tyre cila ka qenë arsyeja që seanca nuk është zhvilluar në sallë. Kësaj pyetje i janë përgjigjur 9% e të intervistuarve dhe reagimet e tyre pasqyrohen në grafikun në vijim.

Grafiku nr. 5 – Arsyet pse seanca nuk u zhvillua në sallë sipas të intervistuarve




Të intervistuarit janë pyetur nëse kanë qenë të pranishëm si në seanca të zhvilluara në salla gjykimi, ashtu dhe në ato të mbajtura në zyrë dhe nëse kanë vënë re ndonjë ndryshim mes tyre, të tilla si ndryshime në sjelljen e palëve ose gjyqtarëve. Rreth 42% e të intervistuarve nuk kanë parë asnjë ndryshim mes seancave të zhvilluara në salla dhe atyre në zyra. Rreth 39% janë përgjigjur se ka ndryshim si dhe kanë dhënë komente në lidhje me atë që ata perceptojnë, mënyrën se si zhvillohet gjykimi në secilin prej rasteve. Rreth 19% e të intervistuarve nuk kanë mundur të japin një përgjigje, sepse për ta ka qenë hera e parë ose e dytë në gjykatë, ose sepse ata kanë qenë gjithmonë të pranishëm në salla gjykimi dhe jo në zyra, ose sepse nuk kanë ditur apo dashur të komentojnë. Më poshtë paraqitet grafiku me të dhënat përkatëse lidhur me këtë pyetje.

Grafiku nr.6 – Të dhëna lidhur me përgjigjet e të intervistuarve nëse ka ndryshim mes zhvillimit të seancës në zyrë dhe në sallën e gjykimit




Të intervistuarit që i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes se ka patur ndryshime mes zhvillimit të seancës gjyqësore në zyrë dhe në sallën e gjyqit, janë pyetur gjithashtu se ku konsistonin këto ndryshime. Sipas tyre, ndryshimet kryesore konsistojnë në elementë si etika dhe solemniteti i trupit gjykues i cili respektohet më mirë në sallën e gjyqit, transparencja e cila është më e lartë në sallë, respektimi më i mirë i procedurave gjyqësore dhe procesit të rregullt garantohet më mirë kur seanca zhvillohet në sallë, etj. Të dhëna më të detajuara pasqyrohen në grafikun në vijim.

Grafiku nr. 7 – Shkaqet e ndryshimit mes zhvillimit të seancës në sallë dhe në zyrë




Gjithashtu, qytetarët janë pyetur për përfitimet e përdorimit të sallave të gjyqit dhe ata janë përgjigjur se zhvillimi i gjykimeve në sallë **së pari** ndihmon në transparencën e veprimeve të ndërmarra nga gjykata ose palët, **së dyti**, është më serioz dhe profesional, **së treti**, parandalon rastet e korrupsionit si dhe së fundmi, është më komod pasi siguron më shumë vende për akomodimin e pjesëmarrësve (të dhënat pasqyrohen në grafikun në vijim).

Grafiku nr. 8 – Përfitimet e përdorimit të sallave të gjyqit sipas të intervistuarve



Nëpërmjet intervistave të veçanta me stafin gjyqësor dhe kryetarët e gjykatave u sigurua informacion mbi kapacitetin e sallave, si dhe përqindjen dhe llojin e seancave që zhvillohen në salla. Ata u pyetën gjithashtu për problematikat në lidhje me sallat e gjyqit dhe përdorimin e tyre në gjykatat përkatëse (shih Shtojcën nr. 5 “Intervistat me stafin e gjykatave, kapaciteti i sallave dhe përdorimi i tyre”). Në shkallë vendi gjenden 170 salla gjykimi të shpërndara sipas gjykatave, sipas grafikut në vijim:

Grafiku nr. 9 – Të dhëna mbi numrin e sallave të gjyqit në 38 gjykatat e monitoruara



Sipas të dhënave të mbledhura nga intervistat, jo të gjitha gjykatat kanë salla të mjaftueshme gjyqi. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë raportohet se nuk është i mjaftueshëm numri i sallave. I njëjti shqetësim vjen edhe nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Shkodër, Elbasan, Durrës, Fier, Gjirokastrë dhe Kavajë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës numri i sallave të gjykimit është 4 dhe mungesa e sallave përbën problematikë kryesore, pasi sipas kryetares së kësaj gjykate, aty ushtrojnë detyrën 17 gjyqtarë me një mesatare 7-8 seanca gjyqësore në ditë dhe në mjaft raste edhe 12-15 seanca gjyqësore në ditë. Kjo bën që të jetë i pamundur zhvillimi i të gjitha gjykimeve në sallë, çka do të rriste respektimin e solemnitetit të procesit nga njëra anë dhe do të ndikonte në rritjen e transparencës ndaj publikut për drejtësinë nga ana tjetër. Në mënyrë të ngjashme, Gjykata Fier ka 5 salla gjyqi për 14 gjyqtarë, ku çdo gjyqtar zhvillon nga 10 deri 15 seanca në ditë. Ky numër i vogël e bën të domosdoshëm rritjen e numrit të sallave të paktën në raportin 1 sallë për 2 gjyqtarë. Gjykata Administrative e Apelit ndodhet në një godinë të caktuar dhe përshtatur provizorisht, por është e nevojshme pajisja me një sallë tjetër. Në mënyrë të ngjashme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka vetëm një sallë. Ngarkesa e gjyqtarit në këtë gjykatë është e lartë dhe ekzistenca e një salle të vetme krijon vështirësi. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka 3 salla dhe 3 gjyqtarë, si dhe 2 gjyqtarë të deleguar dhe për këtë nevojiten më shumë salla dhe personel. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë raportohet se deri në momentin e intervistimit nuk ka patur probleme me sallat e gjyqeve, megjithatë, për të reduktuar në maksimum vonesat një sallë më shumë do ishte zgjidhje, në mënyrë që çdo gjyqtar të ketë në dispozicion një sallë gjykimi.

U konfirmua se 27² nga 38 gjykata i zhvillojnë 100% të seancave në salla gjykimi. Kjo u raportua në Gjykatën e Lartë, Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Vlorë, Tiranë³ dhe atë të Apelit Administrativ, Gjykatat e Apelit Shkodër, Tiranë, Vlorë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krime të Rënda⁴ dhe ato të rretheve gjyqësore Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Pogradec⁵, Pukë, Sarandë, Tropojë, Vlorë dhe Mat⁶. Më shumë se 70% të seancave gjyqësore zhvillohen në salla në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kavajë⁷ dhe atë Administrative Korçë, ndërkohë që më shumë se 50% (gjysma e seancave) zhvillohen në salla në gjykatat e rretheve gjyqësore Durrës dhe Berat. Për shkak të mungesës së sallave të gjykimit në raport me gjyqtarët edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër 60% e seancave zhvillohen në salla gjykimi. Në mënyrë të ngjashme, më pak se 50% e seancave zhvillohen në sallë në Gjykatën Administrative Durrës. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë raportohen 25% të seancave të zhvilluara në salla për shkak të diferencës së madhe të raportit gjyqtar sallë gjykimi. Për të njëjtin shkak, një përqindje e ulët raportohet edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Sipas kryetarit të saj, sallat përdoren vetëm nga gjashtë gjyqtarët e dhomës penale, duke bërë një ndarje një sallë për çdo panel dhe afërsisht 35% e seancave për çdo gjyqtar penalist.

Tryeza e datës 15 Maj 2017 ku u konsultua ky raport evidentoi një sërë zhvillimesh dhe rekomandimesh për përdorimin me më shumë efikasitet të sallave të gjykimit. Faktorët për problematikën e

2 Këto rezultate janë generuar nga formulari për Kryetarin e Gjykatës.

3 Në Gjykatën Administrative Tiranë seancat përgatitore zhvillohen në zyrë ndërsa të gjitha seancat e gjyqësore zhvillohen në sallë gjyqi.

4 Në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda raportohet se çdo seancë gjyqësore zhvillohet në sallë me përfshirje të kërkesave në fazën e hetimeve paraprake për të cilat duhet ruajtur sekreti i hetimit, si p.sh. kërkesat për përgjime, etj.

5 Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec në sallë nuk zhvillohen vetëm kërkesat për lejim përgjimi, në disa raste kur merren masa sigurimi në mungesë, kur seancat zhvillohen në spitale apo jashtë gjykatës dhe sipas dispozitave procedurale.

6 Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat raportohet se çdo seancë gjyqësore zhvillohet në sallë përjashtoj seancat penale për lejim përgjimi, ulje dënimi, kërkesa civile, lëshim urdhër ekzekutimi.

7 Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë vetëm urdhrat e ekzekutimit, përgjimet si dhe ndonjë proces gjyqësor specifik nuk zhvillohet në sallë.


përdorimit të sallave të gjyqit duhet të ndahen në dy faktorë kryesorë, përkatësisht faktori objektiv dhe faktori subjektiv.

Lidhur me **faktorin objektiv**, të gjithë pjesëmarrësit që diskutuan evidentuan kufizimet infrastrukturore të godinave ku janë vendosur një numër i konsiderueshëm gjykatash, shumica e të cilave nuk kanë një numër të mjaftueshëm sallash gjykimi. Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor (ZABGJ) referoi se për të rritur nivelin e përdorimit të sallave të gjykimit kërkohen investime në infrastrukturën ndërtimore çka do të ndihmonte edhe në zgjidhjen e problematikave të tjera të natyrës teknike apo të përdorimit të RDA-së. Në godinat ekzistuese në shumë gjykata të vendit, ZABGJ ka aplikuar standardin 1 sallë për dy gjyqtarë, megjithatë përvoja tregon se nuk mjafton për zhvillimin e të gjitha seancave në salla gjyqi. Shembull për faktin që ky standard nuk garanton zhvillimin e seancave gjyqësore në masën 100% në sallat e gjykimit ishte nevoja e adresuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në godinën e kësaj gjykate ka 4 salla gjyqi dhe janë 5 gjyqtarë dhe është e nevojshme edhe një sallë gjykimi tjetër pasi ka ngarkesë tepër të lartë çështjesh. Përkatësisht, gjatë 2017-ës, nga Janari e deri më tani janë gjykuar rreth 3000 çështje. ZABGJ vuri në dukje investimet e reja në infrastrukturë, konkretisht përurimi i godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe godina e re që është drejt finalizimit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në përmirësimin e situatës, për infrastrukturën e gjykatave të tjera do të ndikojë në mënyrë të veçantë harta e re gjyqësore që është në kompetencë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kjo hartë do të përcaktojë se si do të jetë organizimi i ri i pushtetit gjyqësor dhe vlerësohet se do ketë një përdorim maksimal të sallave ekzistuese dhe më pas do të shihen edhe nevojat për salla të tjera. Me finalizimin e hartës së re gjyqësore, pjesëmarrësit hodhën idenë e ndërtimit të godinave të reja të drejtësisë, me kapacitet të lartë, të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe teknologji moderne. Në mënyrë të veçantë, ndërtimi i këtyre godinave u sugjerua për gjykatat e mëdha sikurse mund të jetë ajo e Tiranës, të cilat do të kenë shtrirje dhe mbulim të gjerë territorial.

Faktori i dytë që ndikon gjithashtu në problemet e evidentuara në raport për përdorimin e sallave të gjyqit është faktori subjektiv që ka të bëjë me efikasitetin e përdorimit të sallave dhe organizimin dhe planifikimin e punës brenda gjykatës. Një nga çështjet e adresuara kishte të bënte me kohën e përdorimit të sallave të gjyqit gjatë një seance gjyqësore. Ky aspekt nuk është monitoruar nga KShH dhe rrjedhimisht nuk disponohen të dhëna që mund t'i bëjmë pjesë të këtij raporti. Megjithatë, pjesëmarrësit hodhën idenë e shfrytëzimit më të mirë të kohës nga gjyqtarët dhe trupat gjykues, me qëllim ekonomizimin e kohës së përdorimit të tyre. Ky është një aspekt që çdo gjykatë mund të monitorojë në një periudhë të caktuar të vitit. Gjithashtu, u rekomandua që oraret e gjykimit të çështjeve të mos përqendrohen në një interval të ngushtë kohor, çka do të ndikonte në rritjen e kërkesave për shfrytëzimin e sallave të gjyqit dhe mospërmbyshjen e nevojave. Shembull për këtë mund të jenë ato raste kur gjyqtarët vendosin që gjykimet t'i bëjnë në ditë të caktuara, duke ngjeshur zhvillimin e seancave në ditët përkatëse, çka ndikon në rritjen e volumit të çështjeve të gjykuara në këto ditë. Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë sugjeroi që gjykimet të zhvillohen në intervalin 8:30 – 15:00 dhe të ketë shpërndarje proporcionale të orareve të gjyqeve gjatë ditës e javës. Kjo kërkon një organizim dhe planifikim më të mirë të gjyqeve dhe përdorimit të sallave të gjyqit, në këtë drejtim mund të vijë në ndihmë programi PAKS+, për administrimin e kalendarit të seancave gjyqësore, i instaluar në të gjitha gjykatat.

Kapitulli IV

Përdorimi i sistemit të regjistrimit digjital audio (RDA)



Niveli i përdorimit të sistemit RDA

Gjatë monitorimit të seancave gjyqësore u evidentua edhe numri i seancave të cilat u zhvilluan me regjistrim audio dhe ato të cilat u zhvilluan pa regjistrimin audio. Gjithsej, volumi i seancave të regjistruara në të gjitha gjykatat arriti në 91,5%. Kjo përqindje ndryshon nga gjykata në gjykatë.


Në 20 gjykata prej 38, të gjitha seancat e monitoruara ose 100% e tyre u regjistruan me mjete audio. Kjo u vëzhgua në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, atë të Apelit Administrativ në Tiranë, në gjykatat e apelit Gjirokastrë, Korçë, Tiranë, Vlorë, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Gjirokastrë, Kavajë, Korçë, Krujë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Mat, Përmet, Pogradec, Pukë dhe Vlorë. 95-99% të seancave të monitoruara u regjistruan në 12 gjykata të tjera dhe pikërisht në Gjykatat Administrative të shkallës së parë Korçë dhe Tiranë, në Gjykatat e Apelit Durrës, Shkodër, Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, në Gjykatën e Lartë, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Durrës, Fier, Kurbin, Sarandë dhe Tropojë. Mbi 75% të seancave të monitoruara u regjistruan në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Vlorë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Shkodër. 63% të seancave të monitoruara u regjistruan në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe 35% e tyre u regjistruan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Duke ju referuar evidencës fillestare të gjeneruar nëpërmjet programit PAKS+ për nivelin e regjistrimit të seancave me sistemin RDA (shih Shtojcën 2), nga monitorimi rezulton një rritje e numrit të gjykatave të cilat e përdorin sistemin 100% ose mbi 90%. Nga evidenca fillestare 28.9% e gjykatave ose 11 e tyre përdornin 100% sistemin RDA. Si më lart, nga monitorimet u gjet se 52.6% e gjykatave ose 20 gjykata e përdornin 100% atë. Përqindja e gjykatave të cilat regjistrojnë me mjete audio mbi 90% të seancave gjyqësore ishte 24% ose 9 në evidencën fillestare, por sipas monitorimeve siç u tha më sipër rezultoi 32% ose 12 gjykata. Nga ana tjetër, përqindja e gjykatave të cilat regjistrojnë me mjete audio nën 90% të seancave gjyqësore ishte 42% ose 16 gjykata në evidencat fillestare, ndërkohë që sipas monitorimeve rezulton në 16% ose 6 gjykata (shih Shtojcën 7).

Siç u përmend, në të gjitha gjykatat në total, një përqindje relativisht e vogël e seancave të monitoruara, vetëm 8.5% (461 nga 5437), nuk u regjistrua me sistemin RDA. Për seancat të cilat u zhvilluan pa përdorur regjistrimin audio, monitoruesit e pranishëm nëpër gjykata bënë përpjekje, aty ku ishte e mundur, për të evidentuar arsyen për të cilën seanca nuk ishte regjistruar dhe nëse kjo ndikohej nga vendi ku ajo po zhvillohej. Kjo mundësi varej nga fakti nëse kryetari i seancës apo sekretari gjyqësor njoftonte palët për shkakun apo informonte të pranishmit se seanca po regjistrohej apo jo me mjete audio. Të dhëna të plota për shkaqet e mospërdorimit të RDA-së u bënë të mundura për 442 nga 461 seanca ose për 96% të seancave të zhvilluara pa përdorimin e RDA. Nga grafiku më poshtë rezulton se 81 % e tyre (pra e 461 seancave) nuk u regjistruan pasi u zhvilluan në zyrë të gjyqtarëve ku nuk është i vendosur sistemi RDA dhe vetëm 15 % e tyre (pra e 461 seancave) nuk u zhvilluan me audio edhe pse seancat u zhvilluan në sallën e gjyqit.

Grafiku nr.10 – Të dhëna lidhur me vendin e zhvillimit të seancës gjyqësore pa RDA

Kategoritë e përqindjeve të seancave të monitoruara pa RDA



Duke ju referuar seancave të monitoruara, për të cilat rezulton se mungoi regjistrimi me sistem RDA, 23% e tyre (107⁸ seanca nga 461) nuk janë zhvilluar në salla sepse rezultoi në mënyrë të qartë se nuk kishte salla të lira gjyqi dhe si rrjedhojë nuk janë regjistruar me mjete audio. Kjo ka ndodhur në gjykatat administrative të shkallës së parë Korçë (1 seancë), Vlorë (5), Durrës (1) dhe Tiranë (1) si dhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda (1), Gjykata e Apelit Shkodër (1), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat (2), Durrës (3), Elbasan (19), Shkodër (24) dhe Tiranë (49).

Mungesa e sallave u vu re përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan ku 6% e seancave të monitoruara nuk mundën të regjistroheshin me mjete audio sepse sallat e gjyqit ishin vetëm dy dhe me urdhër të brendshëm përdoreshin vetëm për çështje penale. Në tri prej këtyre rasteve, monitoruesit kanë vëzhguar se ndërkohë që gjykimi zhvillohej në zyrë, një nga sallat ishte e lirë. ZABGJ vlerëson se godina e re që është drejt finalizimit për këtë gjykatë do t'i japë zgjidhje këtij problemi. Një situatë e ngjashme u vërejt edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku për 9 seanca gjyqtarët njoftuan se nuk mund të zhvilloheshin në sallë sepse u duhet të respektojnë grafikun e paracaktuar për përdorimin e sallave të gjyqit për të cilin është rënë dakord nga Gjykata. Në tri prej këtyre rasteve monitoruesit kanë evidentuar se ndërkohë që gjykimi zhvillohej në zyrë për shkak të grafikut, një nga sallat ishte e lirë.

Ka rezultuar se në 15 % të rasteve, RDA nuk u aplikua teksa seanca gjyqësore zhvillohej në sallën e gjyqit. Shkaqet e referuara nga vëzhguesit lidhen me natyrën e seancës gjyqësore, në rastet kur janë gjykuar çështje me të mitur ose ka patur seanca pajtimi, kur janë zhvilluar seanca përgatitore, kur ka patur defekte në pajisje, probleme me internetin ose kur ka munguar energjia elektrike. Ka edhe raste kur, nuk rezulton i qartë shkaku dhe vëzhguesit kanë dhënë përgjigje të tilla si "gjyqtari nuk informon palët për përdorimin e sistemit audio", "ka neglizhencë nga kryesuesi i trupit gjykues", "nuk është ndezur pajisja", "nuk ka marrë përgjigje nga sekretaria", "nuk verifikohet arsyja", "vendim i gjyqtarit", "zgjedhje e palëve" etj.

Mungesa e energjisë elektrike është konstatuar në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Durrës dhe Shkodër, Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në gjykatat e rretheve gjyqësore Berat, Tiranë, Lezhë, Lushnjë, Sarandë dhe në mënyrë të veçantë në atë

⁸ Duke iu referuar formularit të parë për monitorimin e seancave gjyqësore.

të rrethit Shkodër, ku si në asnjë gjykatë tjetër, numri i seancave të moszhvilluara në sallë për shkak të energjisë elektrike ka qenë 47. Përveç kësaj, në dy seanca të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ato nuk mund të zhvilloheshin në sallë për shkak se në to ishte shumë ftohtë.

Në 5% të seancave të monitoruara, të cilat nuk janë regjistruar me sistemin audio në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës monitoruesit raportuan se seanca mbahet në zyrë sipas planifikimit të gjykatës. Në 5% të seancave të monitoruara, të cilat nuk janë regjistruar me sistemin audio u raportua se bëhej fjalë për seanca përgatitore, këto në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (8), Gjykatën Administrative Vlorë (2), Gjykatën e Rrethit Elbasan (6) dhe atë Tiranë (1). Sipas Kodit të Procedurës Civile, nuk parashikohet që seanca përgatitore të mos regjistrohet me audio. Kështu, sipas nenit 158/a, paragrafi i parë të këtij kodi, e cila zbatohet edhe në gjykimin administrativ për aq sa është e pajtueshme me ligjin e gjykatave administrative parashikohet se **“Gjyqtari cakton, për çdo çështje, seancën përgatitore, ku thirren palët ose personi i tretë, për të përcaktuar natyrën e mosmarrëveshjes dhe kërkon prej tyre shpjegimet e nevojshme, si dhe përcaktimin e provave për vërtetimin e pretendimeve e të prapësimeve të tyre”**. Ndërkohë, sipas nenit 118, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile parashikohet se kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv edhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance.

Një numër i vogël i seancave të monitoruara, 1% e tyre, është bërë kalimi i regjistrimit të çështjes me regjistrim me akses të kufizuar në gjykatat e rretheve Tiranë, Elbasan dhe Shkodër për shkak se në to u diskutuan çështje të lidhura me të mitur apo bëhej fjalë për seanca pajtimi në çështje familjare. Sipas të dhënave të raportuara nga monitoruesit, në një tjetër seancë në Gjykatën e Tiranës mospërdorimi i sistemit audio ishte kërkesë e vetë palëve. Një nga seancat e zhvilluara në Gjykatën e Lartë nuk u regjistrua dhe monitoruesi u informua nga sekretaria gjyqësore se sistemi audio i sallës nuk ishte aktivizuar pasi objekti i gjykimit ishte juridiksion fillestar d.m.th. palët në gjykim ishin deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Çështja gjyqësore ishte e natyrës penale. U vërejt se arsyeja e referuar për mungesën e RDA-së në këtë seancë, nuk përbënte shkak ligjor sipas legjislacionit në fuqi.

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, monitoruesit janë informuar nga kryetari i gjykatës për veçoritë e shqyrtimit të ankimit në dhomë këshillimi në gjykimin administrativ në apel. Sipas nenit 49 të ligjit për Gjykatat Administrative:

“1. Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit.

2. Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht sipas rregullave procedurale në gjykimin civil në Gjykatën e Lartë për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundër ankim.

3. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor.”


Kryetari i Gjykatës së Apelit ndau me monitoruesit edhe një raport që i është përcjellë Këshillit të Lartë të Drejtësisë ku bëhet e ditur se gjatë periudhës 1-31 janar 2017, Gjykata Administrative e Apelit ka zhvilluar 101 seanca në sallë nga të cilat 99 me regjistrim audio dhe 415 seanca në dhomën e këshillimit pa regjistrim audio. Kryetari i kësaj gjykate, gjatë takimit, gjithashtu ka ngritur shqetësimin se raportimi i sistemit audio në Gjykatën Administrative të Apelit që gjenerohet nga sistemi ICMIS nuk bën ndarjen e gjykimeve që zhvillohen në dhomat e këshillimit me gjykimet që zhvillohen në seancë gjyqësore dhe për rrjedhojë nuk jepet një informacion i saktë.

Edhe Kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier evidentoi se në atë gjykatë pjesa më e madhe e seancave përgatitore zhvillohen në zyra. Po ashtu, disa prej tyre zhvillohen në salla por mund të mos regjistrohen me sistemin audio kur zhvillohen në prani të gjyqtarit por pa sekretaren. Seancat që nuk regjistrohen në audio janë edhe kërkesat sekrete në fazën e hetimit, seancat e pajtimit në çështjet familjare, çështjet për të cilat është marrë vendim të zhvillohen me dyer të mbyllura etj, te cilat ligji i ndalon të zhvillohen me regjistrim audio.

Edhe personat e intervistuar të ndodhur në ambientet e gjykatave janë pyetur nëse të gjitha seancat e lidhura me çështjet e tyre janë regjistruar apo jo me sistemin e regjistrimit digjital audio. 68% të tyre janë përgjigjur se seancat gjyqësore në çështjet ku ata kanë qenë palë ose pjesëmarrës janë regjistruar në audio dhe 27% kanë thënë se nuk është përdorur sistemi RDA. Për 5% të të intervistuarve mungon informacioni për të përcaktuar nëse në seancat ku ata kanë marrë pjesë ose kanë qenë palë është përdorur apo jo sistemi RDA.

Grafiku nr. 11 – Të dhëna nga përdoruesit lidhur me përdorimin e RDA-së në seancat ku ata kanë qenë palë/pjesëmarrës


A janë regjistruar në audio të gjitha seancat të lidhura me çështjen/çështjet tuaj/a?



Të dhënat për përqindjen e të intervistuarve, sipas gjykatave të veçanta, të cilët janë përgjigjur se seancat në çështjen e tyre janë regjistruar me mjetet audio paraqitet si vijon:

Grafiku nr. 12 - Të intervistuarit që u janë regjistruar në audio të gjitha seancat

Përqindja e të intervistuarve që janë përgjigjur se u janë regjistruar në audio të gjitha seancat



Infrastruktura e gjykatave në lidhje me sistemin e regjistrimit digjital audio.

Personeli IT u pyet për të vlerësuar infrastrukturën e gjykatës e cila mundëson përdorimin dhe funksionimin e regjistrimit audio. Ata janë pyetur gjithashtu se cilat janë nevojat që paraqiten në drejtim të përmirësimit të kësaj infrastrukture.

Nga punonjësit IT nuk ka patur sugjerime për ndonjë përmirësim në infrastrukturë në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe Tiranë, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, në gjykatat e apelit Shkodër, Gjirokastrë dhe Korçë, në gjykatat e rretheve gjyqësore Dibër, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Vlorë, Kavajë dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Nga ana tjetër, punonjësit IT evidentojnë numrin e vogël të sallave në raport me gjyqtarët në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Elbasan, Berat, Gjirokastrë, si dhe Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe Gjirokastrë. Në Gjykatën e Lartë ndodhen dy salla gjykimi funksionale, me sisteme regjistrimi audio. Gjithsesi, përse i përket sallës së Kolegjeve të Bashkuara, nga Gjykata shihet i nevojshëm sistemi audio më specifik, i përshtatur për llojin dhe infrastrukturën e sallës.

Për Gjykatën e Apelit Vlorë dhe gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë u evidentua nevoja për përmirësimin e infrastrukturës dhe marrjen e masave në lidhje me kapacitetet teknike. Sipas punonjësit IT në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier duhet të ketë një mbështetje (*suport*) të gatshme në lidhje me problemet. Pavarësisht kontrollit të IT, në më shumë se një sallë gjyqi shpesh ka ndërprerje e gjykimit me regjistrimin audio për shkak të bllokimit të sistemit. Në Gjykatën e Apelit Durrës ngrihet shqetësimi kur një pajisje prishet do ishte e nevojshme që gjykata të kishte pajisje rezervë pasi komunikimi me ZABGj kërkon kohë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër eidenton nevojën për përmirësimin e rrjetit elektrik, ndërkohë që në Gjykatën e Rrethit Tropojë nevojitet një gjenerator për funksionimin e sistemit audio edhe kur ka defekt me energjinë elektrike.

Përse u përket problemeve të pajisjeve të ngurta (*hardware*) dhe programeve (*software*) të sistemit RDA, Gjykata e Apelit Tiranë ngre problemin e kapacitetit të ruajtës/arkivimit (*storage*). Gjithashtu kërkohet përshtatshmëri programi (*software*) me sistemin e operimit OS mbi versionin Windows 7 si dhe rinovim të pajisjeve fizike (mikser DMX + mikrofona). Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës raportohet problematika e mosfunksionimit të programit FTR Menaxher me sistemin operativ Windows 10, duke bërë kështu të pengohet dhe update i sistemit operativ Windows 7. Sipas kësaj gjykate, Program FTR Menaxher është i rëndësishëm pasi përdoret nga të gjithë punonjësit të cilët krijojnë CD audio që bashkangjitet dosjes gjyqësore. Në gjykatën e rrethit gjyqësor Kukës kërkohet zëvendësimi i pajisjeve të amortizuara dhe përshtatja me zhvillimin teknologjik. Po ashtu, edhe në gjykatën e rrethit gjyqësor Kurbin nevojiten pajisje më cilësore si *LIPS*, *Bateri*, *CPU*. Në Gjykatën e Lartë kërkohet përmirësimi i *hardware*, parashikim *suporti* për defekte të pariparueshme, *storage – backup*. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës backup i arkivës audio është një proces shumë i rëndësishëm të cilit duhet t'i kushtohet vëmendje maksimale pasi lidhet me sigurinë e të dhënave të kësaj arkive ku ruhen të gjithë regjistrimet audio që nga momenti i implementimit të sistemit FTR.

Programi GFI BackUp Freeware i instaluar në server nuk kryhen funksionin e Backup-it pas ndërrimit të ISP (Kompanisë së Ofrimit të Shërbimit të Internetit) e cila prokurohet çdo vit duke bërë që të dhënat mos të ruhen në serverin qendror. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës raporton se ka hasur vështirësi në procesin konfigurimit të firewall-it pasi nuk ka gjetur mbështetje teknike, ky proces ka zgjatur për disa ditë dhe problemi është zgjidhur me pagesë nga një kompani private. Në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda kërkohet shtimi i një mikrofoni te paneli i avokatit dhe i trupit gjykues. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë kërkon azhurnimin e programit FTR Recorder që të jetë më në përputhje (*kompatibël*) me sisteme më të reja të Windows. Gjykata Administrative Shkodër pretendon se kompjuterët duhet të kenë parametra më të lartë. Në Gjykatën e Rrethit Mat nevojitet që rrjeti të jetë me parametra të kategorisë CAT6. Gjykata e Rrethit Pukë kërkon të merren masa në


mënyrë që sistemi audio të mos ndërpritet disa herë gjatë seancës gjyqësore, ndërsa në Gjykata e Rrethit Durrës propozohet Integrimi i sistemi audio në sistemin ICMIS.

Në tryezën e datës 15 maj gjatë të cilës u konsultuan gjetjet e këtij raporti, ZABGJ referoi se nuk mund të ketë justifikim të mangësive logjistike në gjykata, me arsyetimin se mungon buxheti. Kjo pasi ZABGJ ka ofruar gjithë mbështetjen e saj karshi nevojave për mbështetje logjistike dhe financiare të gjykatave duke i kërkuar atyre vazhdimisht që t'i adresojnë.

Informimi i pjesëmarrësve në proces nga gjykatat.

Nga monitorimet e kryera rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, në 84% të seancave, sekretaria gjyqësore është siguruar përpara se të nisë seanca që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë ulur në vendet përkatëse, për të bërë të mundur regjistrimin audio. Në 12% të seancave, sekretaria gjyqësore nuk është siguruar përpara se të nisë seanca që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë ulur në vendet përkatëse për të bërë të mundur regjistrimin audio.

Grafiku nr. 13 – Të dhëna për orientimet e sekretarisë gjyqësore ndaj palëve lidhur me RDA




Po kështu, në shumicën⁹ e seancave të vëzhguara kur është kryer regjistrimi audio i seancës është konstatuar se gjyqtari që kryesonte seancën, në pjesën më të madhe të rasteve ka informuar në fillim të seancës gjyqësore të gjithë të pranishmit lidhur me regjistrimin.

⁹ 5437 seanca të monitoruara në total. Për 2 prej formularëve nuk mund të nxirren përfundime të sakta si pasojë e mungesës së informacionit të saktë e të plotë.

Grafiku nr. 14 – Njoftimi i palëve nga kryesuesi për RDA në nisje të seancës


A ka njoftuar kryetari në nisje të seancës?



Nëpërmjet studimit është pyetur edhe sekretaria gjyqësore e çdo gjykatë për përmbushjen ose jo të detyrës të njoftimit të palëve nga kryetari i seancës gjyqësore. Përgjigjet e dhëna nga kampioni i të intervistuarve (sekretarët gjyqësorë) kanë treguar se në shumicën e rasteve (90%), pjesëmarrësit njoftohen rregullisht nga kryetari i seancës, në 5% kjo ndodh në disa raste dhe në 2% informimi nuk ndodh.

Grafiku nr. 15 - Të dhëna të marra nga intervistat me sekretarinë gjyqësore për respektimin e detyrimit të kryesuesit të seancës për të informuar palët për RDA

A janë informuar nga kryetari i seancës në fillim të seancës gjyqësore, të gjithë personat e pranishëm se procedimi po regjistrohet audio?




Sekretarët gjyqësorë gjithashtu janë pyetur nëse ka patur raste kur u është tërhequr vëmendja palëve për përdorimin e mikrofonave nga kryetari i seancës si dhe a janë udhëzuar palët që të flasin qartë në mikrofon, të përgjigjen me fjalë dhe të shmangin gjestet ose lëvizjet e kokës, duke qenë se këto gjeste nuk mund të kapen nga regjistrimi. Përgjigjet në shkallë vendi kanë qenë të ndryshme dhe paraqiten në grafikët si më poshtë.

Grafiku nr. 16, nr. 17 dhe nr. 18 - Të dhëna nga sekretarët gjyqësorë për respektimin e detyrimeve nga kryesuesi i trupit gjykues lidhur me përdorimin e RDA


Grafiku nr. 16

A ka patur raste kur u është tërhequr vëmendja palëve për përdorimin e mikrofonëve nga kryetari i seancës?



Grafiku nr. 17


A janë udhëzuar palët që të flasin qartë në mikrofon, të përgjigjen me fjalë dhe të shmangin gjestet?



Nga sekretaria gjyqësore janë raportuar edhe raste kur njëra palë ka kërkuar nga kryetari i seancës që t'i tërhiqet vëmendja apo të merren masa për palën tjetër, në lidhje me përdorimin e duhur të pajisjeve të regjistrimit. 28% e të të intervistuarve janë përgjigjur se ka patur raste të tilla dhe se ndërhyrja e kërkuar ka patur të bëjë me përdorimin e duhur të mikrofonit.

Grafiku nr. 18


Rastet kur i kërkohet kryetarit të seancës disiplinimi i palës tjetër



Përdoruesit e ndodhur në ambientet e gjykatave janë pyetur nëse kanë dëshmuar ose kanë dhënë deklaratime/pohime ndonjëherë gjatë seancës gjyqësore. Vetëm 4358 nga 4929 persona të intervistuar (ose 88% e tyre) i janë përgjigjur pozitivisht kësaj pyetje. Kjo kategori është pyetur në tej nëse është udhëzuar nga gjykata rreth përdorimit të mikrofonit dhe sistemit të regjistrimit audio, ose vendit ku mund të ulëshin dhe të flisnin. Në shumicën e rasteve, (3673 prej tyre ose 84%) janë përgjigjur se kanë marrë udhëzimet përkatëse.

Grafiku nr. 19 – Të dhëna nga përdoruesit/palët e intervistuar të cilët kanë dëshmuar ose dhënë deklaratime/pohime në seancë gjyqësore

A janë udhëzuar nga gjykata rreth përdorimit të sistemit RDA dhe mikrofonit?



Kryetarët e gjykatave janë pyetur nëse ka patur problematika të evidentuara nga gjyqtarët në gjykatën e tyre në lidhje me disiplinimin e palëve dhe zhvillimin e seancës me RDA dhe cilat kanë qenë ato. Në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Elbasan, Gjirokastrë, Dibër, Tropojë, Pukë, Kukës, Përmet, Kavajë dhe Pogradec, në gjykatat e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Shkodër dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, në gjykatat e Krimeve të Rënda dhe në Gjykatën e Lartë nuk janë evidentuar problematika në këtë drejtim. Në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Lezhë, Mat, Sarandë, Shkodër dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Tiranë dhe Durrës janë evidentuar problematika të cilat lidhen kryesisht me disiplinimin e palëve për mënyrën e komunikimit për regjistrimin audio dhe përdorimin e mjeteve teknike që mundësojnë regjistrimin audio.

Përsa i përket informimit të qytetarëve, jashtë seancës gjyqësore, për mënyrën se si duhet të vepron në sallë gjatë regjistrimit me mjete audio, nga intervistat vetëm një pjesë e gjykatave rezulton se e bën këtë informim paraprakisht me anë të ndërgjegjësimit, komunikimit që realizon personeli i gjykatës, etj. Konkretisht, Gjykata e Apelit Durrës referoi se realizon një informim të mjaftueshëm për palët si në ambientet e gjykatës por dhe duke e ofruar me anë të administratës gjyqësore. Në Gjykatën e Apelit Shkodër, informimi bëhet gjithmonë përpara fillimit të seancës gjyqësore. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, Kryetarja raporton se palët tashmë janë në dijeni që seancat zhvillohen me sistem audio, dhe shprehen për gjithçka kërkojnë. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë janë tejkaluar të gjitha problematikat për shkak se palët janë ndërgjegjësuar. I njëjti konstatim vlen për Gjykatën e Lartë.

Të pyetur nëse është i mjaftueshëm informacioni që kanë palët për regjistrimin audio përpara hyrjes në seancë apo nevojitet një ndërgjegjësim më i lartë dhe informim paraprak i tyre, pjesa më e madhe e kryetarëve të gjykatave të intervistuar (74%) janë përgjigjur se është i mjaftueshëm. Megjithatë kryetarët kanë dhënë edhe sugjerime për ta përmirësuar më tej atë. U rekomandua shtimi i organikës së gjykatave me nëpunës gjyqësor që të ndihmojë edhe në lidhje me informimin e publikut e palëve për procesin gjyqësor si dhe organizimi i fushatave sensibilizuese në media. Rekomandimi për të patur në organikën e personelit të gjykatës, punonjës me pozicione për t'i shërbyer publikut dhe për ta informuar atë u mbështet edhe gjatë tryezës së konsultimit të draft raportit në datën 15 Maj 2017.

Nevoja për informimin dhe ndërgjegjësimin e palëve dhe të përdoruesve të gjykatave lidhur me RDA ka lindur si nevojë e problematikave që janë evidentuar nga proceset gjyqësore nga ku rezulton se palët nuk janë shpesh të disiplinuar. Kjo u evidentua qartazi nga intervistat e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë e Berat.


Gjithashtu, intervistat me stafin e gjykatave evidentuan edhe nevoja të tjera të tyre për pozicione të reja në organikë. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Korçë përbën shqetësim mungesa e një punonjësi i cili të mund të garantojë sigurinë e gjyqtarit, siguri e qetësi në sallë, siguri në gjykatë. Po ashtu, në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Tiranë nuk ka nëpunës gjyqësor në organikën e gjykatës për të ndihmuar gjyqtarin në sallën e gjyqit.

Ndërprerja e sistemit të regjistrimit digjital audio.

Procesi i vëzhgimit të seancave ka treguar se në afro 5% të rasteve (278 nga 5437), RDA është ndërprerë gjatë seancës. Shkaqet e ndërprerjes kanë qenë të shumta. Më së shumti ato kanë të bëjnë me tërheqjen e gjykatës për vendim apo shkaqe të tjera ligjore. Megjithatë janë vënë re edhe raste kur

ndërprerja ka ardhur si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike (20%). Disa shkaqe të tjera janë kur diskutohet data e seancës së ardhshme apo problemeve teknike. Një grafik i veçantë paraqet të renditura shkaqet e ndërprerjes sipas përqindjes.

Grafiku nr. 20 Shkaqet e monitoruara për ndërprerjen e regjistrimit audio




Ky paragraf analizon të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm. Lidhur me ndërprerjen e seancave gjyqësore për shkaqe ligjore, rezultojnë se më së shumti ato janë ndërprerë për tërheqjen e trupit gjykues në dhomë këshillimi për të marrë vendim, në rastet kur gjatë seancës janë diskutuar çështje delikate që kishin të bënin me të miturit, sekrete shtetërore, çështje të sigurisë së dëshmitarëve ose të të paditurit, në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore. Mirëpo janë vënë re edhe raste kur ndërprerja është kërkuar nga palët dhe pranuar nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj. Nga grafiku kanë rezultuar edhe raste të ndërprerjes së energjisë apo edhe probleme teknike. Ndërkohë ka patur raste kur seanca është ndërprerë pa shkak ligjor, për të mos pasqyruar disa thënie/diskutime të cilat duhet të jenë pjesë e regjistrimit audio, sikurse janë diskutimet për datën e seancës së radhës. Edhe pse kjo ndodhi në vetëm 20 (ose 7%) seanca nga 287 seanca gjatë të cilave RDA ishte ndërprerë, përsëri gjykohej se kjo cenon transparencën e seancës gjyqësore dhe nuk duhet të ndodhë.

Për ndërprerjen e regjistrimit audio janë pyetur edhe palët dhe përdoruesit e gjykatave nëpërmjet intervistave të cilët kanë ndarë përvojën e tyre. Shumica e të intervistuarve në shkallë vendi (85%) kanë raportuar se gjatë seancës së ndjekur prej tyre nuk ka patur ndërprerje të sistemit RDA, mirëpo 15% e tyre kanë raportuar se diçka e tillë ka ndodhur.


Grafiku nr. 21 – Të dhëna nga palët dhe përdoruesit e gjykatave të intervistuar lidhur me ndërprerjen e RDA

Në dijeninë tuaj, a është ndërprerë ndonjëherë regjistrimi gjatë seancës?




Kategoria e të intervistuarve që janë përgjigjur që ka patur ndërprerje të RDA-së, kanë dhënë edhe përgjigje në lidhje me arsyet e kësaj ndërprerjeje. Përgjigjet përkatëse paraqiten në grafikun “Cila ishte arsyeja e ndërprerjes së regjistrimit audio”. Në përgjigjet e palëve/përdoruesve të gjykatave, mungesa e energjisë elektrike vihet re si arsyeja kryesore e ndërprerjes së sistemit RDA.

Grafiku nr. 22 – Shkaqet për ndërprerjen e regjistrimit audio sipas palëve dhe përdoruesve të gjykatave të intervistuar



Kancelarët e gjykatave, punonjësit IT dhe sekretarët gjyqësorë gjithashtu janë pyetur në lidhje me ndërprerjet e regjistrimit audio.

Kancelarët në një pjesë të madhe të gjykatave raportojnë për raste të shpeshta të ndërprerjes së regjistrimit audio për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike. Grafiku i paraqitur në poshtë tregon se 47% e të intervistuarve në shkallë vendi ka evidentuar këto ndërprerje si shkakun kryesor për ndërprerjen e regjistrimit. Në tryezën e konsultimit të këtij raporti, ZABGJ referoi se ndërprerja e energjisë elektrike nuk mund të jetë shkak për ndërprerjen e RDA-së pasi me përjashtim të 1 ose 2 gjykatave, të gjithë të tjerat janë të pajisur me gjeneratorë. Sipas ZABGJ, gjykatat duhet të marrin masa në mënyrë që kjo mos të jetë shkak pasi nga pikëpamja buxhetore, gjykatave iu janë dhënë të gjitha mjetet. Në 26% të rasteve ndërprerjet gjatë seancës janë bërë kur janë diskutuar çështje delikate që kishin të bënin me të miturit, çështje të sigurisë së dëshmitarëve etj.


Grafiku nr. 23 – Shkaqet për ndërprerjen e regjistrimit audio sipas kancelarëve

Në këtë paragraf detajohen gjetjet e pasqyruara në grafikun e mësipërm sipas gjykatave të monitoruara. Konkretisht, ndërprerja e energjisë elektrike është raportuar nga intervistat e zhvilluara me stafin e Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, Tiranë, Shkodër, Gjykatës së Apelit Durrës, Gjykatës së Apelit të Krimeve të Rënda, Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykatës së Lartë, Gjykatave të Rretheve Gjyqësore Berat, Elbasan, Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Pukë dhe Tropojë. Përsa i përket kësaj problematike, Gjykata e Apelit Vlorë shprehet se në këtë gjykatë ka raste të shpeshta të ndërprerjes. Ndërprerje por më të rralla në numër raportohen në Gjykatën e Apelit Korçë ndërkohë që në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër raportohen probleme për shkak të luhatjes së tensionit. Ndërkohë që defekte në sistemin e RDA-së janë raportuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe Tiranë. Ndërprerja e seancës për një ose më shumë shkaqe ligjore të tilla si diskutimi i çështjeve delikate që kanë të bëjnë me të miturit, diskutimi i çështjeve të sigurisë së dëshmitarëve, sekreteve shtetërore, kur një gjë e tillë kërkohet nga palët dhe pranohe nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj u raportua në Gjykatën e Apelit Vlorë, në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Fier, Sarandë, Vlorë, Krujë, Korçë dhe Përmet, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Nuk raportohen ndërprerje në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Korçë dhe Durrës dhe Gjykatat e Apelit Gjirokastrë dhe Tiranë.

Siç u përmend më sipër, në kuadër të kësaj nisme janë kryer edhe intervista me sekretarët gjyqësorë, të cilët u pyetën gjithashtu në lidhje me ndërprerjet e regjistrimit audio. Në përgjithësi në të gjitha gjykatat, 53% e të intervistuarve raportuan se kishin patur gjatë përvojës së tyre raste kur regjistrimi ndërpritej dhe në 28% prej tyre nuk kishin patur raste të tilla. Sekretarët gjyqësorë të intervistuar janë përgjigjur edhe në lidhje me shkakun e ndërprerjes së regjistrimit audio. Edhe sipas tyre, ndërprerja e energjisë elektrike është arsyeja më e shpeshtë e ndërprerjes së sistemit RDA.


Grafiku nr. 24 - Të dhëna nga intervistat me sekretaret gjyqësore për ndërprerjen e RDA

A është ndërprerë ndonjëherë regjistrimi audio?



Grafiku nr. 25 - Sekretaret gjyqësore për shkaqet e ndërprerjes së regjistrimit

Arsyet e ndërprerjes së regjistrimit audio, sipas sekretareve gjyqësore



Kancelarët e gjykatave janë pyetur edhe se cili personel ndihmës ka ofruar mbështetjen në gjykatë për kryerjen e funksionit të regjistrimit audio dhe përgjigjet kanë qenë uniform, duke përcaktuar se personeli IT dhe sekretaria gjyqësore kanë qenë gjithmonë në gatishmëri.

Defektet teknike dhe problemet me mbajtjen e procesverbaleve audio.

Sekretarët gjyqësorë janë pyetur në lidhje me ndonjë vështirësi të hasur me përdorimin e sistemit të RDA-së. Nga 145 persona të intervistuar, 35 prej tyre (24% të të intervistuarve) raportojnë të kenë hasur probleme.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është raportuar se pavarësisht hedhjes së përmbytjes së seancës, sistemi nuk ka ruajtur informacionin përkatës. I njëjti problem është rapor-


tuar edhe në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ku në një seancë gjyqësore edhe pse ishte hapur FTR (regjistrimi audio) është konstatuar se seanca nuk ishte regjistruar. I njëjti shqetësim është ngritur edhe në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Kurbin. Në mjaft raste, kryesisht në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën e Apelit Tiranë dhe shumë më rrallë në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë dhe Fier është konstatuar bllokim apo ndërprerje e sistemit RDA. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në Gjykatën e Apelit Durrës, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër ndërprerjet e energjisë elektrike ose luhatjet e tensionit kanë sjellë edhe ndërprerjen e RDA-së.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka ankesa se sistemi nuk të lejon të shkruash në rreshtin pas-ardhës.

Intervistat me kryetarët e gjykatave evidentojnë se në regjistrimin audio mbetet problem mosintegrimi me sistemin ICMIS dhe kryerja e veprimeve nga ana e sekretarisë gjyqësore në të dyja sistemet njëkohësisht.

Gjithashtu, stafi i gjykatave është pyetur nëse gjatë regjistrimit ka patur defekte në pajisje. Ndërkohë që 35% e stafit të gjykatës nuk ka hasur kurrë defekte teknike dhe 59% e tyre, kanë hasur vetëm një herë apo rrallë, 6% e tyre sekretarëve janë shprehur se ata kanë hasur shpesh ndërprerjen e regjistrimit për shkak të një defekti në pajisje si në grafikun më poshtë.

Grafiku nr. 26 – Defektet teknike me regjistrimin audio



Defekte të rralla kanë ndodhur pothuajse në të gjitha gjykatat, por ato janë zgjidhur nëpërmjet personelit IT. Kjo raportohet si nga personeli IT, ashtu edhe nga kancelarët dhe sekretarët gjyqësorë të intervistuar. Gjykatat, sekretarët e të cilave kanë evidentuar defekte më të shpeshta kanë qenë ato të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Në një pjesë dërrmuese defektet teknike kanë ardhur për shkak të ndër-

prerjes së energjisë elektrike ose luhatjeve të tensionit, ndonjëherë për shkak të një defekti fizik në pajisjen e mikserit apo prej shkëputjeve të fishave të aparatit.

Sipas punonjësve IT të intervistuar, disa nga problemet më të shpeshta që janë hasur kanë qenë ndërprerja e energjisë elektrike, luhatjet e tensionit që kanë sjellë ndalimin e sistemit, dëmtimi i kablllove, probleme me mikrofoningun, rrjetet tejet të ngarkuar që ka sjellë nxjerrjen jashtë përdorimit të mikserit, probleme me hedhjen e regjistrimeve, probleme në program (*software*), etj. Në Gjykatën Administrative Shkodër një nga problemet në *software* është raportuar se ka një bllokim të orës i cili sjell si pasojë ndalimin e regjistrimit.


Në rastin e djegies, dëmtimit të mikserëve janë ndërmarrë procedurat për zëvendësimin e tyre sa më shpejt duke kontaktuar me ZABGJ-në. Si rezultat janë zëvendësuar kabllot e djegur dhe mikrofonat. Vlen për t'u përmendur se nëpërmjet intervistave të kryera me kryetarët e gjykatave, u evidentuan si të nevojshme pajisje rezervë në rast defekti të rëndë apo djegieje apo prishjeje të aparaturave, mikrofonave, mikserit, etj. Për problemet e *software*, nga intervistat me personelin IT evidentohet se për t'i zgjidhur ato është bërë *restart* i programit. Po kështu, për dëmtimet e shkaktuara nga mungesa e energjisë elektrike është zëvendësuar CD *writer*-i.

Personeli IT i intervistuar në të gjitha gjykatat evidenton se ata kujdesen për testimet, konfigurimet, rikonfigurimet, diagnostifikimin dhe riparimin e defekteve të kohë. Gjithashtu ata ndihmojnë me trajnimin e sekretarëve dhe ndihmën ndaj tyre si përdorues të sistemit.

Në tryezën e konsultimit të këtij raporti u evidentua gjithashtu nevoja për një mbrojtje maksimale të sistemit RDA nga sulmet e mundshme kibernetike. Për këtë lind nevoja që informacioni i regjistruar me audio të ruhet mundësisht në CD ose mjete të tjera të cilat nuk janë të cenueshme nga këto sulme kibernetike. Ruajtja e dublikatës së procesverbalit audio është e rëndësishme pasi dëmtimi i këtij procesverbali ose humbja e tij ndikon në vlefshmërinë e procesit gjyqësor. Lidhur me këtë çështje në tryezë u adresuan rekomandime në drejtim të kryerjes së investimeve të mëtejshme në serverin qendror për regjistrimin digjital audio si dhe realizimit të trajnimeve të vazhdueshme me stafin IT dhe sekretarët gjyqësorë për përdorimin maksimal të mundësive që të jep sistemit në mënyrë që të eliminohen problemet e lidhura me mos njohjen e funksionaliteteve të programit si dhe për të mbrojtur RDA-në dhe arkivin e regjistrimit audio nga sulmet kibernetike.

Kapitulli V

Marrja e kopjeve të regjistrimit audio dhe transkriptimet




Një nga aspektet e monitoruara nga vëzhguesit kishte të bënte me efikasitetin dhe dobishmërinë e përdorimit të sistemit RDA për palët dhe trupin gjykues. Për këtë qëllim, me anë të intervistave të realizuara me stafin dhe përdoruesit e gjykatave u morën të dhëna lidhur me kërkesat për kopje të regjistrimit audio dhe transkriptimet e plota ose të pjesshme të seancës gjyqësore.

Të pyetur për volumin e kërkesave nga palët për marrjen e kopjeve të regjistrimit audio në CD që nga vendosja e regjistrimit audio, kancelarët dhanë këto përgjigje:

- a) Ka patur **shumë kërkesa** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Vlorë, si dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Fier, Tiranë, dhe Vlorë.
- b) Ka patur **rregullisht kërkesa** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Korçë, Krujë, Kurbin, Përmet dhe Pogradec.
- c) Ka patur **disa kërkesa** në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, Shkodër dhe Apelin e Krimeve të Rënda, si dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Lezhë, Lushnje, Mat, Sarandë dhe Shkodër.
- d) Ka patur **pak kërkesa** në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, Korçë, Durrës, Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë, Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Gjirokastrë, Kavajë, Kukës, Pukë dhe Tropojë.

Stafi i gjykatave ka dhënë edhe informacion mbi numrin e kërkesave për marrjen e kopjes elektronike të RDA, të paraqitura në grafikun më poshtë.

Grafiku nr. 27 – Kërkesat për kopje të regjistrimit audio të raportuara nga gjykatat




Shënim: Për Gjykatat e rretheve Durrës, Shkodër, Elbasan, Tiranë, Kurbin, Pukë dhe Lushnjë, gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, nuk u arrit të sigurohej informacion për numrin e kërkesave që nga vendosja e regjistrimit audio. Për Gjykatat e rretheve Kurbin, Pukë dhe Lushnjë, si dhe Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër nuk u arrit të sigurohej informacion për numrin e kërkesave gjatë periudhës shtator 2015 – shtator 2016.

Nga intervistat me kancelarët dhe sekretarët gjyqësorë, kuptohet se kopjet e CD-së janë lëshuar brenda afatit dhe nuk ka patur ankesa nga palët për vonesa në dorëzim. Gjithashtu, konfirmohet nga përgjigjet se palët nuk kanë ngritur ndonjë pretendim në lidhje me pagesën e tarifës për marrjen e kopjes së regjistrimit audio përveçse në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Sekretarët gjyqësorë janë pyetur nëse, në dijeninë e tyre, janë lëshuar kopjet e regjistrimit audio në kohë (24 orë pas pagesës për çështje me vendim përfundimtar, dhe 48 orë për çështje në gjykim) gjatë vitit të fundit (shtator 2015-shtator 2016). Në disa prej gjykatave, respektimi i këtij afati nuk ka qenë i mundur. Kjo ka ndodhur në Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë Korçë, Shkodër dhe Durrës, Gjykatën Administrative të Apelit në Tiranë, Gjykatat e Apelit Durrës, Tiranë, Vlorë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krimet e Rënda, në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kavajë, Kurbin, Lushnjë, Përmet, Sarandë dhe Tiranë. Të dhënat e këtyre përgjigjeve përputhen edhe me të dhënat që rezultojnë nga intervistat me përdoruesit e gjykatave, të cilët janë pyetur nëse gjykata i ka lëshuar kopjet e CD-ve në kohë. Sipas të intervistuarve në shumicën e rasteve (82%) ky afat është respektuar por 13% e tyre janë përgjigjur negativisht.

Grafiku nr. 28 – Të dhëna nga intervistat me përdoruesit e gjykatave lidhur me marrjen e kopjeve të CD për procesverbalet audio

A janë dhënë kopjet në kohë (24 orë pas pagesës për çështje me vendim përfundimtar, dhe 48 orë për çështje në gjykim)?




Stafi i gjykatës është pyetur nëse palët kanë ngritur ndonjë pretendim në lidhje me qartësinë apo kuptueshmërinë e regjistrimit audio në CD. Në shumicën dërrmuese të gjykatave nuk ka patur raste të tilla. Në tri gjykata, përkatësisht në ato të rretheve gjyqësore Dibër dhe Pogradec si dhe në Gjykatën e Apelit Tiranë ka patur pretendime në lidhje me qartësinë/kuptueshmërinë e regjistrimit. Në këto raste, pajisja kompjuterike që është përdorur për të dëgjuar CD-në nuk ka patur të instaluar programin përkatës që lexon diskun ose regjistrimi nuk ishte i dëgjueshëm (zëri i ulët apo shumë zhurmë në sfond).

Edhe personeli IT në disa gjykata ka evidentuar raste kur regjistrimi nuk ishte i dëgjueshëm (zëri i ulët apo shumë zhurmë në sfond), si në gjykatat e Apelit Shkodër dhe Apelit Tiranë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Intervistat me sekretarët gjyqësorë treguan se i njëjti shqetësim është ngritur edhe në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Berat, si dhe në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë. Gjithashtu, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, punonjësi IT ka evidentuar se në procesverbalin audio mungonte ndonjë pjesë nga ato që ishin thënë në seancë.


Edhe qytetarët e intervistuar në gjykata janë pyetur për qartësinë apo kuptueshmërinë e regjistrimit audio në CD-në e marrë nga gjykata. 637 prej të gjithë intervistuarve kishin patur përvojë me marrjen e CD-së me regjistrimin audio nga gjykatat, shumica prej të cilëve (74 %) nuk kishin hasur vështirësi. 141 persona ose 22% e kësaj kategorie që kishin patur një përvojë të tillë, kishin patur vështirësi në hapjen ose dëgjimin e materialit në CD.

Grafiku nr. 29 – Të dhëna nga përdoruesit e gjykatave lidhur me qartësinë dhe kuptueshmërinë e CD-së së procesverbalit audio



Personat e intervistuar të cilët kishin hasur vështirësi me hapjen apo dëgjimin e procesverbaleve audio në CD dhanë shpjegime për natyrën e vështirësisë së hasur. Në shkallë vendi më poshtë vijnë të përqindjet përkatëse. Pjesa më e madhe e vështirësive lidhej me vështirësinë e dëgjimit të fjalëve dhe fjalive. Këto të dhëna theksojnë edhe një herë nevojën e udhëzimit të palëve të flasin qartë në mikrofoni apo trajnimin e vazhdueshëm të stafit të gjykatës, për përdorimin maksimal të sistemit RDA.


Grafiku nr. 30 – Të dhëna nga përdoruesit e gjykatave lidhur me vështirësitë në dëgjimin e CD-së audio



Ndër të tjera, përdoruesit e gjykatave janë pyetur se sa i qartë kishte qenë formulari për kërkimin e kopjeve elektronike të regjistrimit audio, nëse kishin patur një përvojë të tillë. Grafiku në vijim evidenton të dhënat e intervistave, ku për 95% të të intervistuarve ky formular ka qenë plotësisht i qartë dhe vetëm për 2% e të të intervistuarve ai nuk ka qenë i qartë.

Grafiku nr. 31 – Të dhëna nga përdoruesit e gjykatave lidhur me qartësinë e formularit për kërkimin e regjistrimit audio


A është i qartë formulari që plotësohet për të marrë kopje të regjistrimit audio?



Gjithashtu qytetarët janë pyetur për përshtypjet e tyre lidhur me tarifën për të marrë kopjen e RDA-së. 89% e të intervistuarve nuk kanë shfaqur ndonjë pakënaqësi për këtë tarifë, ndërkohë që 8% e tyre kanë shfaqur pakënaqësi. Në këto raste të intervistuarit shprehin ankesën për kosto të lartë, veçanërisht për personat që nuk janë në marrëdhënie pune. Disa prej tyre u ankuan për komisionin e mbajtur nga banka dhe kohën e shpenzuar për të bërë pagesën përkatëse në bankë, si dhe sugjeruan që shpenzimet e CD-së të mbulohen nga gjykata.


Grafiku nr. 32 – Të dhëna nga përdoruesit e gjykatave për përshtypjet e tyre lidhur me tarifën e kopjes së RDA-së

Keni pakënaqësi lidhur me tarifën për marrjen e kopjes së RDA-së?




Në fokus të monitorimit ka qenë edhe marrja e një informacioni lidhur me kërkesat për transkriptim. Nga intervistat e realizuara me stafin e gjykatës, një pjesë e gjykatave kanë dhënë të dhëna statistikore për numrin e këtyre kërkesave nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar, nga ku rezulton se ky numër është relativisht i ulët. Të dhënat paraqiten në grafikun në vijim.

Grafiku nr. 33 – Të dhëna statistikore nga stafi i gjykatës lidhur me kërkesat për marrje të transkriptimit nga palët në gjykim/persona të tjerë të interesuar



Në intervistat e realizuara me sekretarët gjyqësorë është marrë informacion lidhur me shpeshtësinë e kërkesave për transkriptim të bëra nga vetë anëtarët e trupit gjykues. Nga përgjigjet e dhëna rezultoi se ka patur disa herë ose rregullisht kërkesa të tilla në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës, Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë dhe Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krime të Rënda, Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Pukë, Sarandë, Tiranë, Tropojë dhe Vlorë.

Grafiku nr. 34 – Të dhëna statistikore nga stafi i gjykatës lidhur me kërkesat për transkriptim**A është kërkuar transkriptim nga gjyqtari?**

Nuk është raportuar ndonjë ankesë nga palët për transkriptimet. Megjithatë, kur kancelarët janë pyetur nëse është evidentuar ndonjë problematikë përse i përket transkriptimit disa prej tyre kanë referuar vështirësitë që shfaqen për shkak se palët flasin duke qëndruar larg mikrofonit. Këto vështirësi u janë bërë të ditura nga sekretarët gjyqësorë. Në gjykata nuk ka ekspertë për realizimin e transkripteve. Deri tani në disa gjykata, janë kryer nga personeli IT, të cilët hasin vështirësi me terminologjinë juridike të përdorur dhe me identifikimin e folësit pasi nuk kanë qenë prezent në sallë. Sa i takon identifikimit të folësit, argumentet e paraqitura nga personeli IT nuk qëndrojnë pasi ky identifikim bëhet nga mikrofoni ku folësi flet. Lidhur me këtë, personeli IT është trajnuar. Gjithashtu jepen udhëzime përkatëse në materialet e përdorimit të sistemit që janë në gjuhën shqipe dhe u janë shpërndarë të gjithë personelit IT të gjykatave.


Vetë sekretarët gjyqësorë në disa gjykata janë ankuar se transkriptimi është shumë i vështirë dhe kërkon shumë kohë. Ato gjithashtu evidentojnë se në organikën e personelit nuk ka punonjës të veçantë për kryerjen e transkripteve dhe për më tepër as specialistë transkriptimi. Disa herë, sipas tyre, nuk është i mundur të realizohet transkriptimi pasi ka mbivendosje zërash. Herë të tjera flitet shumë shpejt nga palët por në raste të rralla edhe nga gjyqtarët.

Për t'u përballur me këto problematika, disa nga pjesëmarrësit rekomanduan ngritjen e një departamenti ose strukture të veçantë në çdo gjykatë, të pajisur me personelin e nevojshëm dhe të specializuar për realizimin e transkriptimit të procesverbaleve audio.

Edhe një herë këto problematika, tregojnë nevojën e trajnimit të vazhdueshëm të stafit të gjykatës rreth mundësive që të lejojnë programet e sistemit RDA pasi në to ekziston mundësia e ngadalësimit të zërit nëse pjesëmarrësit flasin shpejt apo veçimit të kanalit për një folës të caktuar nëse ka mbivendosje apo pjesëmarrës që flasin në të njëjtën kohë. Gjithashtu nevoja e informimit të pjesëmarrësve për mënyrën e duhur të mbajtjes së fjalës kur përdoret sistemi RDA, identifikohet sërish.

Kapitulli VI

Vlerësimet dhe sugjerimet e stafit dhe përdoruesve të gjykatës për RDA




Gjatë intervistave të realizuara me stafin dhe përdoruesit e gjykatave, vëzhguesit kanë marrë informacion mbi perceptimet dhe vlerësimet e tyre për rëndësinë që ka sistemi i RDA-së dhe nevojat që duhet të adresohen për përmirësimin e tij.

Komentet dhe vlerësimet më të rëndësishme që janë dhënë nga kryetarët e gjykatave për sistemin RDA përmbledhen në paragrafin në vijim: *“Programi funksionon shumë mirë dhe ka sjellë dobishmëri në punën e përditshme të gjyqtarëve dhe sekretarëve gjyqësorë”.... “Përdorimi i sistemit të regjistrimit audio në gjykatë, përveç se rrit transparencën dhe besimin e publikut ndihmon në ekonominë gjyqësore dhe rritjen e cilësisë dhe saktësisë së mbajtjes së procesverbalit. Për lehtësimin e procesit është e nevojshme integrimi i këtij sistemi me atë ICMIS”..... “Sistemi i regjistrimit audio në gjykatë RDA, përbën një revolucion në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Ai sjell standardet e sistemit tonë në standardet e vendeve të zhvilluara të BE”.....“Nga ana e KLD-së na është kërkuar përfshirja në informacionin periodik mujor edhe informacioni në lidhje me funksionimin e sistemit audio. Qysh nga viti 2014, ne raportojmë në KLD për përdorimin e sistemit. Kjo na ndihmon për kontrollimin e vonesave në fillimin e seancave gjyqësore, mund të shohim oraret fikse të fillimit të seancave me qëllim minimizimin e çdo vonesë”.*

Përdoruesit e gjykatave kanë vlerësuar më së shumti se regjistrimi audio shmang keqkuptimet, ndihmon në transparencën e veprimeve të ndërmarra nga gjykatat dhe palët, parandalon korrupsionin dhe është më i saktë në krahasim me procesverbalin e mbajtur me shkrim dore ose kompjuter. Të dhëna më të detajuara paraqiten në grafikun në vijim:


Grafiku nr. 35 – Të dhëna nga përdoruesit e gjykatave lidhur me përfitimet e RDA-së



Përdoruesit e gjykatave që janë intervistuar u është kërkuar një vlerësim për shërbimin e gjykatës lidhur me regjistrimin audio. Në shkallë vendi, 69% e tyre, janë përgjigjur se ky shërbim është i kënaqshëm, 24% të tyre nuk ishin në gjendje të bënin një vlerësim dhe vetëm 5 % e tyre kanë vlerësuar se shërbimi nuk është i kënaqshëm.. Të dhënat për çdo gjykatë jepen si Shtojca 6 e këtij raporti.

Grafiku nr. 36 – Të dhëna nga përdoruesit e gjykatave lidhur me vlerësimin për shërbimin e Gjykatës për RDA

Vlerësimi juaj për shërbimin e gjykatës lidhur me regjistrimin audio




Gjatë realizimit të intervistave me stafin e gjykatës, sekretarët gjyqësorë kanë bërë disa sugjerime për të përmirësuar punën e tyre në lidhje me regjistrimin audio. Pjesa më e madhe e sugjerimeve ka të bëjë me lehtësimin e procesit të transkriptimit duke e hequr këtë detyrë nga sekretaria gjyqësore dhe duke e mundësuar transkriptimin nëpërmjet një punonjësi të veçantë, të specializuar në këtë fushë, pajisjen e gjykatave me pajisjet e nevojshme për realizimin e transkriptimit, pjesëmarrjen e stafit të gjykatës në trajnime të vazhdueshme ku të angazhohen ekspertë të fushës së RDA-së dhe transkriptimit etj., reduktimin e shënimeve që mbahen gjatë seancës. Sugjerime të tjera lidhen me shtimin e sallave të gjyqit dhe pajisjen e tyre me infrastrukturën e nevojshme për RDA-në, përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të RDA-së. Lidhur me lehtësimin e punës së sekretareve gjyqësore gjatë regjistrimit audio, sugjerimi i adresuar konsiston në drejtim të shënimit në sistem vetëm të kohës kur flet folësi dhe më pas të bëhet përmbledhja e reduktuar. Gjithashtu, sekretarët gjyqësorë sugjeruan adoptimin e mënyrave më të thjeshta të hedhjes së procesverbalit audio në CD pasi është një proces që merr shumë kohë, në kushtet e ngarkesës së tyre. Lidhur me përmirësimet në infrastrukturën e sistemit të RDA-së në gjykata, sugjerimet e tyre konsistojnë në drejtim të garantimit të mbarëvajtjes së regjistrimit audio gjatë gjithë seancës dhe mosndërprerjes së tij, të merren masa që

sistemi të mos bllokohet vetvetiu, nëse regjistrimi shkëputet të ketë një tabelë paralajmëruese që shfaqet në mënyrë automatike në kompjuter, të përmirësohet rrjeti elektrik në gjykata dhe të shtohen mikrofonat në sallat e gjykimit.

Punonjësit IT, gjatë intervistave dhanë gjithashtu disa sugjerime kryesisht të natyrës teknike, për rritjen e përdorimit dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit RDA në gjykata. **Së pari**, u sugjerua që duhet t'i mundësohet IT-së riparimi i rrjetit të brendshëm të gjykatës. **Së dyti**, u sugjerua të zhvillohen trajnime në mënyrë të vazhdueshme për personelin IT në gjykata, me qëllim që përdorimi i sistemit dhe mbarëvajtja e tij të shënojë rezultate të larta e cilësore. Specifikisht u sugjerua zhvillimi i trajnimeve për ri-nstalimin e programit apo riparime të dëmtimeve të *software*-it të sistemit të bazës së të dhënave. **Së treti**, u sugjerua realizimi i takimeve periodike midis IT-ve të të gjitha gjykatave në funksion të njësimit të praktikës së punës për sistemin audio dhe shkëmbimit të përvojave pozitive. **Së katërti**, u sugjerua përmirësimi i *hardware*, mbështetjes dhe riparimit në rast të defekteve të riparueshme, *storage* për *backup*-et e sistemit audio. **Së pesti**, u sugjerua marrja e masave për të minimizuar dhe reduktuar pengesat që vijnë në sistemin e regjistrimit audio si rezultat i ndërprerjeve të energjisë elektrike. Specifikisht u sugjerua që rrjeti elektrik i sallave të gjyqit të shkëputet nga pjesa tjetër e rrjetit të gjykatës dhe të pajiset me infrastrukturën e nevojshme që ndërprerjet në rrjet të mos ndikojnë në ndërprerjet e sistemit audio. **Së gjashti**, u sugjerua kryerja e verifikimeve dhe kontrolleve periodike për pajisjet e sistemit audio, për të paraprirë rastet e mosfunksionimit të pajisjeve. Gjithashtu u sugjerua zëvendësimi i pajisjeve të RDA-së të bëhet çdo tre vjet në salla si dhe të azhurnohen programet e FTR-së. **Së shtati**, u sugjerua që dhënia e regjistrimeve audio duhet të bëhet në CD që u jepen palëve me numër, logo dhe të dhënat e pamodifikueshme të gjykatës. **Së fundmi**, u sugjerua që të realizohen ndërhyrjet dhe përmirësimet e nevojshme me qëllim që sistemi i regjistrimit audio të jetë i sigurt.

Kapitulli VII Përfundime



Publiciteti i seancës gjyqësore është një nga aspektet më të rëndësishme të procesit të rregullt, ndërkohë që zbatimi i sistemit RDA në gjykata përbën një kërkesë të detyrueshme ligjore, çka garanton saktësi të nivelit të lartë të dokumentimit të seancës gjyqësore dhe rrit transparencën, efikasitetin si dhe përmirëson administrimin e gjykatave.

Përdorimi i sistemit të regjistrimit digjital audio është i rregulluar si në Kodin e Procedurës Civile dhe në atë Penale. Në kuadër të Reformës në Drejtësi janë miratuar ndryshime të Kodit të Procedurës Penale, të cilat përmirësojnë dhe saktësojnë dispozitat për përdorimin e RDA në procesin penal. Megjithatë, pavarësisht këtyre përmirësimeve, vërehet se neni 118 i Kodit të Procedurës Civile e fillon dispozitën me rregullin që kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur ky procesverbal nuk mund të mbahet nëpërmjet këtij sistemi. Ndërkohë që neni 115 i Kodit të ri të Procedurës Penale, rregullin dhe përjashtimin i ka reflektuar në të njëjtën fjali ku thuhet se “Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv.” Në këtë vështrim, vërejmë se Kodi i Procedurës Civile përmban një rregullim ligjor më të qartë dhe më të plotë, duke ofruar garanci më të larta ligjore për detyrimin e përdorimit të RDA-së.

Rregullim përkatës gjejmë edhe në Ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Ndërkohë, rregulla më të hollësishme për mbajtjen e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio parashikohen në Udhëzimin nr. 353, datë 3.9.2013 të Ministrit të Drejtësisë.

Raporti përmban gjetje të përgjithshme në nivel makro si dhe gjetje në nivel mikro të grupuara sipas gjykatave, me qëllim që çdo gjykatë të ketë mundësi të vlerësojë vështirësitë dhe mundësitë për përdorimin sa më efikas të sallave dhe sistemit RDA.

Draft raporti është konsultuar fillimisht në tryezën e datës 15 Maj 2017, ku morën pjesë të gjitha gjykatat e monitoruara, me prezencën e një pjesë të kryetarëve, kancelarëve dhe stafit IT të këtyre gjykatave si dhe ju është përcjellë më pas në rrugë elektronike të gjitha gjykatave duke i lënë kohën e nevojshme në dispozicion për të dhënë komentet dhe sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të tij.

Qëllimi i këtij monitorimi tepër dinamik dhe intensiv që për herë të parë u shtri në të gjitha gjykatat e vendit, ishte marrja e të dhënave sasiore dhe cilësore mbi përdorimin e sallave të gjyqit dhe sistemit RDA. Për të realizuar këtë nismë u hartua një plan i detajuar mbi procesin e monitorimit me datat përkatëse dhe metodologjinë e realizimit të çdo monitorimi dhe intervistave. Nga vlerësimi i bërë paraprakisht, para se të fillonte monitorimi, me anë të të dhënave të gjeneruara nga PAKS+, rezulton se për periudhën nga shtatori 2015 deri në qershor 2016, 29% e gjykatave kishin arritur të regjistronin 100 % të seancave gjyqësore.

Regjistrimi i seancave gjyqësore nëpërmjet sistemit RDA ka rezultuar një hap i rëndësishëm për rritjen e transparencës gjyqësore në Shqipëri. Ky konstatim del shumë shpesh në pah nga të dhënat e mbledhura nëpërmjet këtij monitorimi që u shtri në të 38 gjykatat e vendit.

Komentet dhe vlerësimet më të rëndësishme që janë dhënë nga kryetarët e gjykatave për sistemin RDA përmbledhen në paragrafin në vijim:

“Programi funksionon shumë mirë dhe ka sjellë dobishmëri në punën e përditshme të gjyqtarëve dhe sekretarëve gjyqësorë”.... “Përdorimi i sistemit të regjistrimit audio në gjykatë përveç se rrit transparencën dhe besimin e publikut ndihmon në ekonominë gjyqësore dhe rritjen e cilësisë dhe saktësisë së mbajtjes së procesverbalit. Për lehtësimin e procesit është e nevojshme integrimi i këtij sistemi me atë ICMIS”..... “Sistemi i regjistrimit audio në gjykatë RDA, përbën një revolucion në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Ai sjell standardet e sistemit tonë në standardet e vendeve të zhvilluara të BE”.....“Nga ana e KLD-së na është kërkuar përfshirja në informacionin periodik mujor edhe informacioni në lidhje me funksionimin e sistemit audio. Qysh nga viti 2014, ne raportojmë në KLD për përdorimin e sistemit. Kjo na ndihmon për kontrollimin e vonesave në fillimin e seancave gjyqësore, mund të shohim oraret fikse të fillimit të seancave me qëllim minimizimin e çdo vonesë”.

Vëzhguesit e KShH-së e realizuan këtë monitorim gjatë periudhës Janar – Mars 2017, ku u monitoruan 5437 seanca gjyqësore, u pyetën 4929 përdorues gjykatash dhe u intervistuan të gjithë kryetarët , kancelarët, punonjësit IT dhe 37% të sekretarëve gjyqësorë në të 38 gjykatat e vendit.

Të dhënat e raportuara nga vëzhguesit evidentojnë se pjesa me e madhe e seancave, 93% e seancave të monitoruara u zhvillua në salla gjykimi. Përsa u përket seancave të cilat nuk u zhvilluan në sallat e gjyqit, në total 7% e tyre, vëzhguesit arritën të marrin informacion se në 29% të tyre shkak lidhej me mungesën e sallave të lira.

Të dhënat e raportuara evidentojnë një numër mjaft të ulët të palëve që gjatë seancave u ankuan për moszhvillimin e seancës gjyqësore në sallën e gjykimit. Në shkallë vendi kjo ka ndodhur vetëm në 0,2% të seancave gjyqësore të monitoruara. Raportohet një numër i ulët i seancave të vëzhguara, përkatësisht 2% e tyre, ku pjesëmarrësit janë detyruar të largohen nga zyra e gjyqtarit për shkak të mungesës së hapësirës.

Palët dhe përdoruesit e gjykatave janë pyetur nëse kanë qenë të pranishëm si në seanca të zhvilluara në salla gjykimi, ashtu dhe në ato të mbajtura në zyrë dhe nëse kanë vënë re ndonjë ndryshim mes tyre, të tilla si ndryshime në sjelljen e palëve ose gjyqtarëve. Rreth 39 % janë përgjigjur se ka ndryshim si dhe kanë dhënë komente në lidhje me atë që ata perceptojnë mënyrën se si zhvillohet gjykimi në secilin prej rasteve. Sipas tyre, ndryshimet kryesore konsistojnë në elementë si etika dhe solemniteti i trupit gjykues, i cili respektohet më mirë në sallën e gjykimit, transparenca e cila është më e lartë në sallën e gjykimit, respektimi më i mirë i procedurave gjyqësore dhe procesit të rregullt garantohet më mirë kur seanca zhvillohet në sallë, etj.

27 nga 38 gjykata konfirmuan se i zhvillojnë 100% të seancave në salla gjykimi. Kjo u raportua në Gjykatën e Lartë, gjykatat administrative Shkodër, Vlorë, Tiranë dhe atë të Apelit Administrativ Tiranë, Gjykatat e Apelit Shkodër, Tiranë, Vlorë, Durrës, Gjirokastrë, Korë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krime të Rënda, dhe ato rretheve Dibër, Gjirokastrë, Korçë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë, Tropojë, Vlorë dhe Mat. Më shumë se 70% të seancave zhvillohen në salla në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, Kavajë dhe atë Administrative Korçë, ndërkohë që më shumë se 50% (gjysma e seancave) zhvillohen në salla në gjykatat e rretheve gjyqësore Durrës dhe Berat. Për shkak të mungesës së sallave të gjykimit në raport me gjyqtarët edhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër 60% e seancave zhvillohen në salla gjykimi. Në mënyrë të ngjashme, më pak se 50% e seancave zhvillohen në sallë në Gjykatën Administrative Durrës. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë raportohen 25% të seancave të zhvilluara në salla për shkak të diferencës së madhe të raportit gjyqtar sallë gjykimi. Për të njëjtin shkak një përqindje e ulët raportohet edhe në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Faktorët për problematikën e përdorimit të sallave të gjyqit duhet të ndahen në dy faktorë kryesorë, përkatësisht faktori objektiv dhe faktori subjektiv. Faktori objektiv konsiston në kufizimet infrastrukturore të godinave ku janë vendosur një numër i konsiderueshëm gjykatash, shumica e të cilave nuk kanë një numër të mjaftueshëm sallash gjykimi. Zhvillime pozitive në këtë drejtim përbëjnë investimet aktuale në infrastrukturën e gjykatave, konkretisht inaugurimi i godinës së re të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe godina e re që është drejt finalizimit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Faktori subjektiv ka të bëjë me efikasitetin e përdorimit të sallave, kohëzgjatjen e shfrytëzimit të tyre nga trupat gjykues dhe organizimin dhe planifikimin e punës brenda gjykatës.

Përsa i përket përdorimit të Sistemit të RDA, gjithsej, volumi i seancave të regjistruara me këtë sistem, në të gjitha gjykatat e vendit arriti në 91.5%. Megjithatë, kjo përqindje ndryshon nga gjykata në gjykatë.

Në të gjitha gjykatat në total, një përqindje relativisht e vogël e seancave të monitoruara, vetëm 8.5%, nuk u regjistrua me sistemin RDA. Për seancat të cilat u zhvilluan pa përdorur regjistrimin audio, monitoruesit e pranishëm nëpër gjykata bënë përpjekje, aty ku ishte e mundur, për të evidentuar arsyen për të cilën seanca nuk ishte regjistruar. Të dhëna të plota për mospërdorimin e RDA-së u bënë të mundura për 95.9% të seancave të zhvilluara pa përdorimin e RDA.

Ka rezultuar se në 15.2% të rasteve, RDA nuk u aplikua teksa seanca gjyqësore zhvillohej në sallën e gjyqimit. Shkaqet e referuara nga vëzhguesit lidhen me natyrën e seancës gjyqësore, në rastet kur janë gjykuar çështje me të mitur ose ka patur seanca pajtimi, kur janë zhvilluar seanca përgatitore, kur ka patur defekte në pajisje, probleme me internetin ose kur ka munguar energjia elektrike. Për pjesën tjetër të seancave të gjykuara në sallën e gjyqimit pa RDA, nuk rezulton i qartë shkaku i mospërdorimit të këtij sistemi.

Edhe personat e intervistuar të ndodhur në ambientet e gjykatës janë pyetur nëse të gjitha seancat e lidhura me çështjet e tyre janë regjistruar apo jo me sistemin RDA. 72% të tyre janë përgjigjur se seancat gjyqësore në çështjet ku ata kanë qenë palë ose pjesëmarrës janë regjistruar në audio dhe 28% kanë thënë se nuk është përdorur sistemi RDA.

Nga monitorimet e kryera rezulton se në pjesën më të madhe të rasteve, në 85% të seancave, sekretaria gjyqësore është siguruar përpara se të nisë seanca që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë ulur në vendet përkatëse për të bërë të mundur regjistrimin audio. Kampioni i të intervistuarve (sekretarët gjyqësorë) kanë treguar se në 91% të rasteve pjesëmarrësit njoftohen rregullisht nga kryetari i seancës dhe vetëm 6% është përgjigjur se kjo ndodh në disa raste.

Të pyetur nëse është i mjaftueshëm informacioni që kanë palët për regjistrimin audio përpara hyrjes në seancë apo nevojitet një ndërgjegjësim më i lartë dhe informim paraprak i tyre, pjesa më e madhe e kryetarëve të gjykatave të intervistuar (74%) janë përgjigjur se është i mjaftueshëm. Nevoja për informimin dhe ndërgjegjësimin e palëve dhe të përdoruesve të gjykatave lidhur me RDA ka lindur si nevojë e problematikave që janë evidentuar nga proceset gjyqësore, nga ku rezulton se palët nuk janë shpesh të disiplinuar. Kjo u evidentua qartazi nga intervistat e zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Gjykatën e Apelit Vlorë, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë e Berat.

Procesi i vëzhgimit të seancave ka treguar se në shumicën e rasteve (95%) nuk ka patur ndërprerje të regjistrimit digjital të seancave. Ka patur edhe raste (5%) kur regjistrimi audio është ndërprerë gjatë seancës. Në këto raste të dhënat tregojnë se, në pjesën më të madhe regjistrimi audio është ndërprerë përkundrejt legjislacionit. Ndërkohë ka patur raste sporadike kur seanca është ndërprerë

pa shkak ligjor, për të mos pasqyruar disa thënie/diskutime të cilat duhet të jenë pjesë e regjistrimit audio, sikurse janë diskutimet për datën e seancës së radhës. Ndërprerja e sistemit të regjistrimit digjital audio cenon transparencën dhe procesin e rregull ligjor.


Kancelarët në një pjesë të madhe të gjykatave raportojnë si shkak për ndërprerjen e regjistrimit audio ndërprerjen e energjisë elektrike. Po kështu edhe të intervistuarit në shkallë vendi ka evidentuar këtë ndërprerje si shkakun kryesor për ndërprerjen e regjistrimit. Në tryezën e konsultimit të këtij raporti, ZABGJ referoi se ndërprerja e energjisë elektrike nuk mund të jetë shkak për ndërprerjen e RDA-së pasi me përjashtim të 1 ose 2 gjykatave, të gjithë të tjerat janë të pajisur me gjeneratorë.

Sekretarët gjyqësorë, të pyetur lidhur me ndërprerjen e RDA, evidentuan se, 53% e tyre kishin patur gjatë përvojës së tyre raste kur regjistrimi ndërpritej dhe 28% e tyre nuk kishin patur raste të tilla.

Të pyetur për volumin e kërkesave nga palët për kopje të regjistrimit audio në CD që nga vendosja e regjistrimit audio, shumica e gjykatave rezultojnë se ka patur shumë, disa ose rregullisht kërkesa të tilla. Qytetarët e intervistuar në gjykata janë pyetur për qartësinë apo kuptueshmërinë e regjistrimit audio në CD-në e marrë nga gjykata. 13% (637) e të gjithë intervistuarve kishin patur përvojë me marrjen e CD-së me regjistrimin audio nga gjykatat, prej të cilëve, 437 persona nuk kishin patur vështirësi dhe 141 persona kishin patur vështirësi në hapjen ose dëgjimin e materialit në CD. 95% i të intervistuarve që kishin patur përvojë në marrjen e CD-së deklaruan se formulari për kërkimin e saj ishte plotësisht i qartë dhe vetëm për 2% e të të intervistuarve ai nuk ka qenë i qartë. 89% që kishin patur përvojë në marrjen e CD-së deklaruan se nuk kanë pakënaqësi për tarifën e marrjes së CD-së, ndërkohë që 8% e tyre kanë shfaqur pakënaqësi.

Nga intervistat e realizuara me stafin e gjykatës, një pjesë e gjykatave kanë dhënë informacion statistikor për numrin e kërkesave për transkriptimin e procesverbalit audio nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar, nga ku rezultojnë se ky numër është relativisht i ulët. Sekretarët gjyqësorë pohojnë se ka patur disa herë ose rregullisht kërkesa të tilla nga trupi gjykues ose anëtarë të tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Durrës, Gjykatën Administrative të Apelit, Gjykatat e Apelit Durrës, Gjirokastrë dhe Tiranë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krime të Rënda, Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Pukë, Sarandë, Tiranë, Tropojë dhe Vlorë. Nuk është raportuar ndonjë ankesë nga palët për transkriptimet, ndërkohë që stafi i intervistuar i gjykatave pohon se ndeshen vështirësi në realizimin e transkriptimit për shkak se thëniet e palëve nuk dëgjohen qartë, ka mbivendosje zërash, flitet shumë shpejt nga palët por në raste të rralla edhe nga gjyqtarët, mungojnë burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e transkriptimit, etj. Raportimi i këtyre problematikave evidenton një njohje jo të mirë të programit të sistemit RDA, pasi ekziston mundësia e ngadalësimit të zërit nëse pjesëmarrësit flasin shpejt apo veçimit të kanalit për një folës të caktuar, nëse ka mbivendosje apo pjesëmarrës që flasin në të njëjtën kohë. Vetë sekretarët gjyqësorë në disa gjykata janë ankuar se transkriptimi është shumë i vështirë dhe kërkon shumë kohë.

Kapitulli VIII Rekomandime



Me anë të këtij raporti dëshirojmë t'ju vijmë në ndihmë institucioneve të drejtësisë me qëllim që të përmirësojnë problematikat e evidentuara. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti i paraqiten edhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë të Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Kuvendit, etj, duke shpresuar në hartimin e politikave dhe strategjive apo mbështetjen financiare për kapërcimin e vështirësive që hasin gjykatat me qëllimin final për përdorimin 100% të sallave të gjyqit dhe të sistemit të regjistrimit audio. Tryeza e datës 15 Maj 2017 ku u konsultua ky raport evidentoi një sërë rekomandimesh, një pjesë e të cilave reflektohen në këtë kapitull.

I. Për të rritur nivelin e përdorimit të sallave të gjykimit kërkohen investime në infrastrukturën ndërtimore të godinave të gjykatave, çka do të ndihmonte edhe në zgjidhjen e problematikave të tjera të natyrës teknike apo të përdorimit të RDA. Investimet që do të bëhen në godinat ekzistuese si dhe ato të reja duhet të synojnë drejt standardit që numri i sallave të jetë në përputhje me ngarkesën e gjykatës dhe numrin e gjyqtarëve.

II. Në përmirësimin e situatës nga pikëpamja e infrastrukturës për sallat e gjykimit, do të ndikojë në mënyrë të veçantë harta e re gjyqësore që është në kompetencë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me finalizimin e hartës së re gjyqësore, rekomandohet ndërtimi i godinave të reja, me kapacitet të lartë, të pajisura me të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe teknologji moderne. Veçanërisht, ndërtimi i këtyre godinave u sugjerua për gjykatat e mëdha sikurse mund të jetë ajo e Tiranës, të cilat do të kenë shtrirje dhe mbulim të gjerë territorial.

III. Rekomandohet të rritet efikasiteti i përdorimit të sallave nga gjykatat që nuk kanë numër të mjaftueshëm sallash gjykimi. Në këtë drejtim, rekomandohet shfrytëzimi më i mirë i kohës nga gjyqtarët dhe trupat gjykues, me qëllim ekonomizimin e kohës së përdorimit të sallës së gjykimit gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore. Inkurajohen të realizohen nga kryetarët e gjykatave, me ndihmën e personelit mbështetës, vëzhgime/studime periodike për të vlerësuar kohëzgjatjen e seancave gjyqësore nga trupat gjykues në sallat e gjykimit. Kjo do të ndihmonte në marrjen e masave efektive të brendshme organizative për rritjen e nivelit të përdorimit të sallave të gjykimit. Rekomandohet që oraret e gjykimit të çështjeve të mos përqendrohen në një interval të ngushtë kohor, çka do të ndikonte në rritjen e kërkesave për shfrytëzimin e sallave të gjyqit dhe mospërmbushjen e nevojave. Shpërndarja proporcionale e orareve të gjyqeve gjatë ditës e javës brenda gjykatës do të rriste nivelin e përdorimit të sallave dhe të RDA-së.

IV. Gjithashtu, rekomandohet të ketë një organizim dhe planifikim më të mirë të punës brenda gjykatave që kanë mungesa në numrin e sallave të gjykimit. Konkretisht rekomandohet që planifikimi të jetë i tillë me qëllim shfrytëzimin maksimal të sallave, për të evituar në çdo rast zhvillimin e seancës gjyqësore në zyrën e gjyqtarit ndërkohë që salla e gjykimit është e lirë. Sugjerohet që gjykimet të zhvillohen në intervalin 8:30 – 15:00 dhe të ketë shpërndarje proporcionale të orareve të gjyqeve gjatë ditës e javës. Për një planifikim më të mirë të gjyqeve dhe përdorimit të sallave të gjyqit mund të vijë në ndihmë programi PAKS+, për administrimin e kalendarit të seancave gjyqësore, i instaluar në të gjitha gjykatat. Për gjyqtarët duhet të ketë kritere më të qarta, kur lihet në diskrecion të tyre zhvillimi i një numri të caktuar seancash gjyqësore në sallën e gjykimit. Përparësi në këtë rast mund t'i jepet seancave gjyqësore që kanë palë ndërgjygjëse dhe dëshmitarë, të cilat duhet të kenë transparencë dhe publicitet më të lartë, në kushtet kur gjykata ka mangësi në sallat e gjykimit.

V. Monitorimi ka evidentuar se praktikat e ndjekura nga gjykatat janë të ndryshme dhe në disa raste seancat përgatitore nuk regjistrohen me RDA. Në këtë drejtim, rekomandohet që çdo kontakt i gjykatës me palët në proces qoftë edhe në seancë përgatitore duhet të dokumentohet me sistemin RDA, nëse është e mundur. Ky rekomandim është në frymën e ligjit procedural, i cili parashikon mbajtjen e procesverbalit RDA edhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor të kryer jashtë seancës gjyqësore.

VI. Në rastet kur seanca gjyqësore nuk zhvillohet në sallë apo në rastet kur ajo zhvillohet në sallë por për shkaqe të ndryshme nuk regjistrohet me RDA, rekomandohet që shkaku i moszhvillimit të seancës gjyqësore në sallë dhe/ose shkaku i mosregjistrimit të seancës me RDA të shënohet nga sekretari gjyqësor nën orientimin e kryetarit të trupit gjykues, në procesverbalin me shkrim të kësaj seance.

VII. Sugjerohet gjithashtu që në bazë të legjislacionit në fuqi të vazhdohet me një orientim sa më të kujdesshëm të palëve nga gjykata për përdorimin e mikrofonave dhe për të folurinqartë.

VIII. Rekomandohet që gjykatat të kenë një bashkërendim më të mirë me ZABGJ, në drejtim të adresimit në mënyrë të vazhdueshme të të gjitha nevojave që kanë të bëjnë me përdorimin e sallave të gjyqit dhe sistemit të RDA-së. Në këtë drejtim, është i rëndësishëm që ZABGJ të vazhdojë të ofrojë të gjithë mbështetjen e saj për vlerësimin dhe adresimin në mënyrë të drejtë të nevojave për mbështetjen logjistike dhe financiare të gjykatave.

IX. Rekomandohet që të gjitha gjykatat të cilat nuk kanë gjeneratorë të pajisjen me gjeneratorë me kapacitet e cilësi të lartë, me qëllim që ndërprerjet e energjisë elektrike apo çdo luhatje në sistem të mos ndikojë në ecurinë e regjistrimit audio të seancës. Në lidhje me ndërprerjet e energjisë, u sugjerua që rrjeti elektrik i sallave të gjyqit të shkëputet nga pjesa tjetër e rrjetit të gjykatës dhe të pajiset me infrastrukturën e nevojshme që ndërprerjet në rrjet të mos ndikojnë në ndërprerjet e energjisë elektrike për sistemin e regjistrimit audio.

X. Ndërgjegjësimi i qytetarëve dhe përdoruesve të gjykatave për rëndësinë që ka zhvillimi i seancës në sallën e gjykimit dhe regjistrimi i saj me RDA përkundrejt legjislacionit në fuqi është tepër i rëndësishëm. Rekomandohet gjithashtu që organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë të jenë aktive në organizimin e fushatave sensibilizuese në media për rritjen e këtij ndërgjegjësimi. Në kuadër të organizimit të ri gjyqësor, rekomandohet shtimi i organikës së gjykatave me nëpunës gjyqësor që të ndihmojë edhe në lidhje me informimin e publikut e palëve për procesin gjyqësor.

XI. Në tryezën e konsultimit të këtij raporti u evidentua gjithashtu nevoja për një mbrojtje maksimale të sistemit RDA nga çdo dëmtim i brendshëm apo i jashtëm, duke përfshirë edhe sulmet e mundshme kibernetike. Për këtë lind nevoja që informacioni i regjistruar me audio të ruhet mundësisht në CD ose mjete të tjera. Ruajtja e dublikatës së procesverbalit audio është e rëndësishme pasi dëmtimi i këtij procesverbali ose humbja e tij ndikon në vlefshmërinë e procesit gjyqësor. Rekomandohet kryerja e investimeve të mëtejshme në serverin qendror për regjistrimin digjital audio si dhe realizimit të trajnimeve me stafin IT dhe sekretaret gjyqësore për të mbrojtur maksimalisht RDA dhe arkivin e regjistrimit audio. Një bashkëpunim më i mirë duhet vendosur edhe me Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, ku është i vendosur serveri qendror i regjistrimeve audio.

XII. Të bëhen përpjekje për përmirësimin e infrastrukturës së gjykatave në lidhje me sistemin e regjistrimit digjital audio. Për këtë sugjerohet përmirësimi i *hardware*, mbështetjes dhe riparimit në rast të defekteve të pariparueshme, *storage* për *backup*-et e sistemit audio. Gjithashtu, rekomandohet kryerja e verifikimeve dhe kontroleve periodike për pajisjet e sistemit audio, për të paraprirë rastet e mosfunksionimit të pajisjeve si dhe zëvendësimi periodik i pajisjeve të RDA-së në salla, si dhe përditësimi i programeve të FTR-së. Pavarësisht se nga IT kryhen të gjithë procedurat e nevojshme për Backup të të dhënave, duhet që institucionet e tjera të cilat janë pjesë e këtij procesi siç është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ku qëndron dhe serveri qendror i arkivës së regjistrimeve audio, të bashkëpunojnë duke ofruar asistencë teknike për Gjykatat në rast nevojë


XIII. Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me RDA kur kërkohet të realizohet nga gjyqtari i çështjes apo nga palët, kërkon mbështetje logjistike dhe me burime njerëzore të specializuara në të gjitha gjykatat e vendit. Sugjerojmë që pranë gjykatave që kanë ngarkesë të shikohet mundësia e angazhimit të ekspertëve të jashtëm të specializuar për kryerjen e transkriptimit, në varësi të kërkesave për transkriptim nga anëtarët e trupit gjykues dhe numrit të kërkesave të personave të interesuar që janë miratuar nga gjykata.

XIV. Rekomandohet realizimi i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit IT dhe sekretarët gjyqësorë për përdorimin sa më efektiv dhe profesional të sistemit të regjistrimit audio dhe nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete ose tryeza të cilat synojnë shkëmbimin e përvojave pozitive brenda apo jashtë vendit.

XV. Rekomandohet të vlerësohen e adresohen nevojat e tjera që kanë gjykata të caktuara lidhur me mungesën e punonjësve të sigurisë apo punonjësit që orientojnë palët dhe publikun në sallë si dhe ndihmojnë gjyqtarin të mbajë qetësinë në sallën e gjykimit.

Shtojca 1

Kuadri ligjor për mbajtjen e procesverbalit me mjete audio dhe për përdorimin e sallave



Mbajtja e procesverbalit me mjete audio

Kodi i Procedurës Civile

Neni 118

“Kryetari i seancës duhet të sigurohet që të mbahet procesverbal nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv për seancën gjyqësore, si dhe për çdo veprim tjetër procedural gjyqësor që zhvillohet jashtë seance. Më tej, ky nen përcakton se nëse nuk është e mundur që procesverbal të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim. Në të njëjtin nen, më poshtë Kodi shprehet se “Procesverbal është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohë sa edhe vetë dosja”.

Neni 119

“Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive përgatitet nga sekretari gjyqësor, ose teknikë të kontraktuar nga gjykata dhe që veprojnë nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor.” Në këtë nen vijohet se “Transkriptimi i procesverbalit bëhet në rastet kur: a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues; b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i seancës gjyqësore, pasi paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim, e cila përcaktohet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”

Neni 77

“.. sekretari lëshon, kundrejt pagesës, kopje të akteve të përpiluara, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim.

Kodi i Procedurës Penale në fuqi gjatë periudhës së monitorimit

Neni 115

“Dokumentimi i veprimeve bëhet me procesverbal. Procesverbal përpilohet nga sekretari i gjykatës, në formë të plotë ose të përmbledhur, me stenotipi, me mjet tjetër teknik dhe, kur mungojnë këto mjete, me dorëshkrim. 3. Kur procesverbal përpilohet në formë të përmbledhur duhet të bëhet edhe riprodhimi fonografik dhe, po të jenë kushtet, edhe riprodhimi audioviziv kur është i domosdoshëm.”

Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar në vitin 2016

Neni 115

Procesverbal i seancës

1. Veprimet procedurale të kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo veprim procedural i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv të seancës. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore.

2. Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.

3. Nëse nuk është e mundur që procesverbal të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim, nën mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.

4. Procesverbal duhet të tregojë: a) tregimin e vendit, të vitit, të muajit, të ditës dhe të orës, në të cilat ka filluar dhe është përfunduar; b) përbërjen e gjykatës; c) emrin e prokurorit; 9) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për to identifikuar, gjeneralitetet e mbrojtësve, viktimës akuzuese, palëve private dhe të përfaqësuesve të tyre. d) gjeneralitetet e personave që marrin pjesë në gjykim; dh) nëse është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.

5. Procesverbali duhet të përshkruajë veprimet procedurale të kryera gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë në mënyrë të përmbledhur: a) të gjitha kërkimet dhe pretendimet e palëve; b) reflektimin e saktë të emërimit të çdo parashtrimi, memorie apo bisedimeve përfundimtare të paraqitura me shkrim nga palët, duke treguar edhe numrin e fletëve; c) pyetjet dhe deklaratimet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët; 9) provat e marra, duke përfshirë përmbajtjen e provave me shkresë që janë paraqitur, të shiritave të magnetofonit, diapozitivave e filmave; d) të gjitha vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit;

6. Në rast se procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim dhe një nga palët kërkon që pjesë nga thëniet e saj apo të palës tjetër të përfshihen në procesverbal, gjykata duhet të marrë parasysh këtë kërkesë.

7. Memoriet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, i bashkohen procesverbalit.

8. Nëse procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund të dokumentit nga kryetari i trupit gjykues dhe përfshihet në dosjen gjyqësore. Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për aq kohe sa ruhet dosja gjyqësore.

9. Nëse mbahet me regjistrim audio ose audioviziv, regjistrimi ruhet programin aplikativ elektronik përkatës për aq kohë sa ruhet dosja gjyqësore.

10. Palët kanë të drejtë në çdo kohë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit të mbajtur me shtypshkrim apo dorëshkrim kundrejt tarifave përkatëse."

Neni 116

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete te regjistrimit audio ose audiovizive

1. Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete te regjistrimit audio ose audiovizive bëhet nga sekretari gjyqësor ose nën mbikëqyrjen e tij nga teknikët të kontraktuar nga gjykata për këtë qëllim, duke evidentuar në mënyrë të saktë të gjithë përmbajtjen e regjistrimit.

2. Transkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe personi që ka kryer atë.

3. Transkriptimi i procesverbalit bëhet kur: a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues; b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i trupit gjykues, pasi paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Nëse transkriptimi i procesverbalit kërkohet pas përfundimit të gjykimit, mbi kërkesën vendos Kryetari i gjykatës.

4. Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin. Nëse kryhen gjatë gjykimit, materialet e transkriptimit i bashkëlidhen dosjes gjyqësore dhe janë pjesë përbërëse e saj.

5. Për dokumentimin e veprimeve procedurale gjatë fazës së hetimeve paraprake zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e mësipërme."

Neni 122

Pavlefshmëria e procesverbalit dhe regjistrimit

1. Procesverbali i mbajtur me shtypshkrim ose dorëshkrim është i pavlefshëm kur ka dyshime rreth identitetin të personave që kanë marrë pjesë ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar.

2. Regjistrimi me mjete audio ose audiovizive është i pavlefshëm për pjesën në të cilën përmbajtja e regjistrimit nuk është e kuptueshme."

Ligj nr. 35/2017 datë 30.3.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Neni 115

Procesverbali i seancës

1. Kur është e mundur, aktet e kryera gjatë seancës gjyqësore, si dhe çdo akt tjetër i kryer jashtë saj, dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore.
2. Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.
3. Kur nuk është e mundur që procesverbali të mbahet nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, ai mbahet duke bërë një përmbledhje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim, nën mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.
4. Procesverbali duhet të tregojë:
 - a) tregimin e vendit, vitit, muajit, ditës dhe orës, në të cilat ka filluar dhe është përfunduar;
 - b) përbërjen e gjykatës;
 - c) emrin e prokurorit;
 - ç) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, gjeneralitetet e mbrojtësve, viktimës akuzuese, palëve private dhe të përfaqësuesve të tyre.
 - d) gjeneralitetet e personave që marrin pjesë në gjykim;
 - dh) kur është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.
5. Procesverbali duhet të përshkruajë çdo akt të kryer gjatë gjykimit dhe të pasqyrojë në mënyrë të përmbledhur:
 - a) kërkimet dhe pretendimet e palëve;
 - b) pasqyrimin e saktë të emërimit të çdo parashtrimit, memorieje apo diskutimi përfundimtar të paraqitur me shkrim nga palët, duke treguar edhe numrin e fletëve;
 - c) pyetjet dhe deklaratimet e personave që marrin pjesë në gjykim, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët;
 - ç) provat e marra;
 - d) vendimet dhe urdhrat që ka dhënë gjykata gjatë gjykimit.
6. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim dhe njëra nga palët kërkon që pjesë nga thëniet e saj apo të palës tjetër të përfshihen në procesverbal, gjykata duhet ta marrë parasysh këtë kërkesë.
7. Memoriet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, i bashkohen procesverbalit.
8. Kur procesverbali mbahet në formë të përmbledhur me shtypshkrim apo dorëshkrim, ai nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga sekretari dhe në fund nga kryetari i trupit gjykues. Procesverbali është pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore dhe ruhet për atë kohë sa ruhet ajo.
9. Kur mbahet me regjistrim audio ose audioviziv, regjistrimi ruhet në programin elektronik përkatës për atë kohë sa ruhet dosja gjyqësore.
10. Palët kanë të drejtë në çdo kohë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit të mbajtur me shtypshkrim apo dorëshkrim, kundrejt tarifave përkatëse.

Neni 116

Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive

1. Transkriptimi i procesverbaleve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive bëhet nga sekretari gjyqësor ose nën mbikëqyrjen e tij nga teknikë të caktuar nga gjykata për këtë qëllim, duke treguar në mënyrë të saktë të gjithë përmbajtjen e regjistrimit.
2. Transkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe personi që e ka kryer atë.
3. Transkriptimi i procesverbalit bëhet kur:

- a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues;
- b) kërkohet me shkrim nga palët në gjykim dhe kjo kërkesë miratohet nga kryetari i trupit gjykues, pasi paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Drejtësisë. Kur transkriptimi i procesverbalit kërkohet pas përfundimit të gjykimit, mbi kërkesën vendos kryetari i gjykatës.
- 4. Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të veçanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së palës që kërkon transkriptimin. Nëse kryhen gjatë gjykimit, materialet e transkriptimit i bashkëlidhen dosjes gjyqësore dhe janë pjesë përbërëse e saj.
- 5. Për dokumentimin e akteve gjatë fazës së hetimeve paraprake zbatohen, për aq sa është e mundur, dispozitat e mësipërme.

Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"

Neni 34

"Seanca gjyqësore zhvillohet sipas neneve të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj. Duhet evidentuar se neni 3 i këtij ligji shprehet se gjykata administrative, sipas natyrës së çështjes, shqyrton çështjen gojarisht në seancë gjyqësore ose mbi bazë aktesh shkresore në dhomë këshillimi.

Neni 49

"Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Më tej neni vijon "Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton palët rregullisht për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbahet procesverbal nga sekretari gjyqësor."

Udhëzimi nr. 353, datë 3.9.2013 të Ministrit të Drejtësisë "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio".

Neni 4

Regjistrimi audio i seancës gjyqësore

1. Regjistrimi audio i seancës gjyqësore kryhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të seancës gjyqësore, duke përdorur pajisjet digjitale të posaçme për regjistrimin

Neni 6

Kryetari i seancës gjyqësore

1. Kryetari i seancës gjyqësore mbikëqyr procesin e regjistrimit të seancave gjyqësore dhe, për këtë qëllim, i jep udhëzime sekretarit gjyqësor, si dhe u jep urdhra palëve, përfaqësuesve të tyre dhe pjesëmarrësve në seancë gjyqësore. 2. Për mbarëvajtjen e procesit të regjistrimit, kryetari i seancës gjyqësore, ndër të tjera: a) në fillim të seancës gjyqësore, informon të gjithë personat e pranishëm se procedimi po regjistrohet elektronikisht; b) udhëzon palët që të flasin qartë në mikrofon, të përgjigjen me fjalë dhe të shmangin gjestet ose lëvizjet e kokës, pasi këto gjestet nuk mund të kapen nga regjistrimi; c) sigurohet që regjistrimi të realizohet në përputhje me rregullat e këtij udhëzimi dhe të

përmbajë të dhënat e kërkuara; ç) vendos për mbajtjen e procesverbalit në mënyra të tjera, në rastet e parashikuara në këtë udhëzim; d) vendos ta ndërpresë ose ta kufizojë aksesin e regjistrimit, në rastet kur gjatë seancës diskutohen çështje delikate që kanë të bëjnë me të miturit, sekrete shtetërore, të dhëna financiare të palëve, çështje të sigurisë së dëshmitarëve ose të të paditurve ose kur një gjë e tillë kërkohet nga palët dhe pranohet nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit procedural në fuqi

Neni 7

Sekretari gjyqësor

1. Sekretari gjyqësor është përgjegjës për: a) vënien në funksionim të pajisjeve të regjistrimit; b) regjistrimin e plotë e të saktë të seancave gjyqësore; c) firmosjen e shënimeve të përmbledhura (indeksit-lognotes) që shoqërojnë regjistrimin audio; ç) transkriptimin e regjistrimeve audio, kur kërkohet; d) arkivimin e regjistrimeve; dhe dh) lëshimin e kopjeve të vërtetuara të regjistrimit origjinal, në formë të pamodifikueshme, në CD-të e paraqitura paraprakisht nga palët, si dhe të kopjeve të vërtetuara të shënimeve origjinale, pas pagesës së plotë të tarifës përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. 2. Sekretari gjyqësor realizon detyrat e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni në përputhje me

Neni 9 Teknikët e mjeteve

Në raste të caktuara, në përmbushjen e detyrave të tij, për regjistrimin e seancave gjyqësore dhe transkriptimin, nëse është e nevojshme, sekretari gjyqësor ndihmohet nga persona me njohuri teknike, të cilët nuk janë punonjës të gjykatës, por janë kontaktuar prej saj për këtë qëllim. Në çdo rast, sekretari gjyqësor mbikëqyr procesin e regjistrimit dhe transkriptimit dhe mban përgjegjësi për të.

Neni 11

Masat përgatitore para seancës gjyqësore

Para fillimit të seancës gjyqësore, sekretari gjyqësor, krahas detyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet e regjistrimit të funksionojnë si duhet. Ndër të tjera, sekretari gjyqësor: a) kontrollon që të gjitha pajisjet të jenë lidhur në priza dhe të furnizohen me energji elektrike; b) kontrollon që të gjitha pajisjet të jenë lidhur me bateritë (UPS) përkatëse dhe që gjeneratori të jetë në gjendje pune dhe i gatshëm për t'u ndezur, nëse ndërpritet energjia elektrike; c) kontrollon që të gjithë mikrofonat të jenë të lidhur me kanalet përkatëse; ç) sigurohet që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë ulur në vendet përkatëse për të bërë të mundur regjistrimin audio; d) sigurohet që ka në dispozicion mjetet e nevojshme për mbajtjen e procesverbalit në një mënyrë alternative, kur kjo është e nevojshme

Neni 19

Pajisja e palëve me kopjen e regjistrimit

1. Palët, kur dëshirojnë të kenë një kopje të certifikuar të origjinalit të regjistrimit, paraqesin kërkesë në sekretarinë gjyqësore. 2. Sekretari gjyqësor u jep palëve kopje të certifikuara të origjinalit të regjistrimit në CD në formë të pamodifikueshme (read only), si dhe kopje të certifikuara të shënimeve origjinale, sipas disponimit të kryetarit të seancës, pas pagesës së plotë nga palët të tarifës së vendosur, sipas legjislacionit në fuqi. 3. CD-të e përdorura duhet të sigurohen nga vetë palët. 4. Kopjet e origjinaleve të përmendura më sipër u jepen palëve brenda 24 orëve pas përfundimit të gjykimit dhe 48 orëve nga pagesa e tarifës së vendosur, kur çështja është ende në gjykim. 5. Në rast refuzimi të kërkesës së palëve për pajisjen e tyre me kopje të certifikuara të origjinalit të regjistrimit, kryetari i seancës arsyeton vendimin e tij dhe ky arsyetim i bëhet i ditur palës kërkuuese. 6. Çdo informacion shtesë i kërkuar nga palët shqyrtohet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e gjykatës me publikun.

Neni 22

Përgatitja e transkriptim

1. Transkripti i regjistrimit përgatitet nga sekretari gjyqësor ose teknikët audio të kontraktuar nga gjykata dhe që janë nën mbikëqyrjen e sekretarit gjyqësor, në rastet kur: a) kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues; b) kërkohet nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar, me kusht që ata ta argumentojnë me shkrim këtë kërkesë dhe në rast se kjo kërkesë miratohet nga kryetari i seancës gjyqësore, si dhe pasi të paguhet tarifat e vendosura për këtë qëllim

Vendimi Unifikues Penal Nr.2 i datës 27.04.2015 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

Me anë të këtij vendimi, Kolegji Penal ka shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara çështjen e mëposhtme:

1. Mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore, si akt për dokumentimin e veprimeve në seancë gjyqësore, nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, a duhet të konsiderohet në përputhje me nenin 115 e vijues të Kodit të Procedurës Penale?

IV. Arsytimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (ekstrakt nga vendimi unifikues)

29. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se çështja që mund të shkaktojë një keqkuptim apo keqinterpretim mbi atë çka përbën procesverbal apo mbi mënyrën e mbajtjes së tij është, pikërisht nënshkrimi, i parashikuar si element, mungesa e të cilit pasjellë pavlefshmëri, sipas neneve 122 dhe 345/2 të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa ligjore e “detyrimit për nënshkrimin”, që mund të çojë në argumentin se procesverbalet janë të pavlefshëm, kur nuk janë të nënshkruar nga personeli që i ka përpiluar ato, është e zbatueshme vetëm për procesverbalet e mbajtura me mjetin me shkrim. Prandaj, ky argumentim nuk e ndalon apo përjashton mbajtjen e procesverbalit të vetëm me mjetin alternativ të audios apo audiovideos.

30. Meqenëse neni 115 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon që procesverbali të mbahet me mjetet e disponueshme teknike, dhe duke qenë se dispozita mbi nënshkrimin i referohet vetëm procesverbalit me shkrim, atëherë mund të konkludohet se “rregulli i nënshkrimit” nuk është i zbatueshëm për regjistrimin audio apo audiovideo, dhe rrjedhimisht dispozitat e nenit 122 dhe nenit 345/2 i K.Pr.Penale, gjejnë zbatim vetëm kur procesverbali është mbajtur me shkrim. Në këto kushte, mungesa e shënimeve apo transkriptimeve kur është zgjedhur mjeti kryesor i dokumentimit të veprimeve procedurale nëpërmjet regjistrimit audio ose audiovideo duhet të konsiderohet si një parregullsi, e cila mund të ndreqet kryesisht nga gjykata apo palët e interesuara, duke kërkuar shënimin apo transkriptimin e pjesëve relevante të verbalit audio apo audiovideo.

31. Në përgjigje të pyetjes së shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore nëpërmjet regjistrimit audio dhe audioviziv, është jo vetëm në përputhje me nenin 115 e vijues të K.Pr.Penale, por duke u parashikuar prej tij si një nga mjetet e mbajtjes së procesverbalit, rrit efektivitetin, eficiençën dhe garanton transparencën në seancat gjyqësore duke përmbushur në mënyrë shteruese dhe autonome funksionin dokumentues të veprimeve procedurale.

32. Meqenëse Kolegjet e Bashkuara kanë çmuar si të pajtueshëm me ligjin procedural mbajtjen e procesverbalit me mjetin teknik të audios apo audiovideos, e vlerësojnë si të nevojshme të ndalen në çështjen e pasjes së mundësisë për kuptimin dhe lehtësimin e përdorimit në mënyrë efikase nga ana gjykatës të procesverbalit audio apo audiovideo. Veçanërisht kjo, në lidhje me “procesverbalin e

seancës gjyqësore”, i cili përbën dhe objektin kryesor të çështjes së shtruar për unifikim, si edhe për zgjidhjen e rekursit objekt gjykimi para Kolegjeve të Bashkuara.

33. Dokumentimi i veprimeve procedurale me anë të mjetit teknik audio apo audiovideo duhet të bëhet në përputhje me parimin e procesit të rregullt në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNj-së. Kjo do të thotë se gjykata, kur e çmon të nevojshme, qoftë kryesisht, qoftë me kërkesë të palëve, përveç mundësisë së mbajtjes së shënimeve të sekretarit të sinkronizuara në procesverbalin audio apo audiovideo, duhet të disponojë sa herë që kërkohet apo e çmon të nevojshme, transkriptimin e atyre pjesëve relevante që konsiderohen si të nevojshme për qëllime të gjykimit dhe ushtrimit të drejtave ligjore që u janë njohur palëve.

34. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë, se nisur nga fakti se procesverbali i vetëm i seancës, i hartuar me mjetin e regjistrimit audio apo video, është një mjet alternativ dhe kryesor për dokumentimin e veprimeve procedurale, mungesa e pasqyrimin apo përshkrimin të plotë të thënieve të dëshmitarit apo provave të tjera të tipit deklarativ nuk duhet të konsiderohet nga ana e gjykatës së apelit si shkak pavlefshmërie, që ndikon në prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por në këto raste gjykata e apelit, qoftë edhe kryesisht, duhet të disponojë transkriptimin e audio verbalit apo video verbalit, me qëllim që të formojë bindjen e saj të brendshme dhe të realizojë funksionin kryesor të saj, atë të dhënies së drejtësisë.

35. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në kushtet kur ofrohet një lloj i mbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqësore me mjet më efektiv, mbajtja e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjetin e dorëshkrimit në formë të përmbledhur, është një formë më pak efektive sesa format e plota të dokumentimit të veprimeve në seancë. Në rastet kur gjykatat e themelit do të procedojnë me hartimin e procesverbalit me mjetin e dorëshkrimit në formë të përmbledhur, ato duhet të arsyetojnë në mënyrë të detajuar rreth shkaqeve që kanë diktuar përzgjedhjen e një mjeti dokumentimi më pak efektiv sesa ai alternativ të mbajtjes së procesverbalit me llojin audio, apo audiovideo. Arsye që duhet të jenë vetëm objektive, të tilla siç mund të jenë: mungesa e mbajtjes së procesverbalit me mjetin kryesor për shkak të pamundësisë së teknologjisë, mungesa apo defektet e paparashikuara të impiantit, mungesa e energjisë elektrike, etj. ...

Mbi sallat e gjykimit

Kodi i Procedurës Civile

Neni 173

Gjykimi me dyer të mbyllura

Në pajtim me nenin 26 të këtij Kodi, gjykimi i çështjeve tërësisht ose pjesërisht në seancë me dyer të mbyllura lejohet me vendim të arsyetuar të gjykatës, vetëm kur: a) është e nevojshme të ruhet një sekret shtetëror dhe rendi publik; b) përmenden sekrete tregtare, shpikjesh nga publikimi i cilave do të cenoheshin interesa që mbrohen me ligj; c) përmenden rrethana nga jeta intime private e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Në gjykimin e çështjeve me dyer të mbyllura lejohen të qëndrojnë në sallën e gjyqit vetëm palët, përfaqësuesit e tyre, dëshmitarët, ekspertët dhe me lejen e gjykatës edhe persona të tjerë. Nuk lejohet qëndrimi në seancë gjyqësore i të miturve nën 16 vjeç, përveç kur thirren nga gjykata. Vendimi për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura duhet të shpallet publikisht.

Neni 178

Sigurimi i rregullit dhe i qetësisë në seancë gjyqësore

Kryetari i seancës gjyqësore kujdeset për mbajtjen e rregullit e të qetësisë në seancë. Ai ka të drejtë të urdhërojë largimin nga salla e gjyqit të personave që prishin rregullin e qetësinë e zhvillimit të seancës gjyqësore. Kur prokurori ose avokati nuk u binden urdhrave të kryetarit të seancës gjy-

qësore, gjykata vë në dijeni organin përkatës të prokurorisë ose të këshillit drejtues të avokatisë dhe kërkon prej tyre marrjen e masave disiplinore. Gjkata mund të shtyjë seancën derisa të caktohet një prokuror ose një avokat tjetër.

Kodi i Procedurës Penale në fuqi gjatë realizimit të monitorimit

Neni 341

Drejtimi i seancës

1. Drejtimi i seancës bëhet nga kryetari. Urdhrat e tij për ruajtjen e rendit e të qetësisë janë të detyrueshme për palët e pjesëmarrësit dhe të zbatueshme nga organet e rendit. Ata që pengojnë zhvillimin e rregullt të seancës nxirren jashtë me urdhër të kryetarit dhe kur nuk binden dënohen me gjobë deri në dhjetë mijë lekë. Urdhri është i paankimueshëm.
2. Kur kryhet një vepër penale në sallën e gjykimit, prokurori procedon në bazë të ligjit dhe, kur është rasti urdhëron arrestimin e autorit.

Ligj nr. 35/2017 datë 30.3.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

"Neni 341"

Drejtimi i seancës

1. Drejtimi i seancës bëhet nga kryetari i trupit gjykues. Urdhrat e tij për ruajtjen e rendit e të qetësisë në seancë janë të detyrueshme për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim.
2. Kryetari ka për detyrë të marrë masa për garantimin e respektimit të autoritetit të gjykatës, solemnitetit të gjykimit dhe sigurisë në sallë, si dhe për shmangien e çdo fyerjeje, kërcënimi apo sulmi tjetër të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në gjykim.
3. Kur i pandehuri, mbrojtësi, viktimi, dëshmitari, eksperti apo përkthyesi nuk zbaton urdhrat e gjykatës për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë, fyen autoritetin e gjykatës apo kryen veprime që cenojnë solemnitetin e gjykimit, kryetari e paralajmëron atë për pasojat. Kur personi vijon të prishë rregullin e qetësinë dhe të mos bindet, gjykata mund t'i caktojë gjobë deri në shumën 30000 lekë. Përsëritja e shkeljes përbën shkak për largimin nga salla.
4. Ndaj urdhrit të mësipërm mund të bëhet ankim me shkrim brenda 3 ditëve. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi nga e njëjta gjykatë. Kur e çmon të arsyeshme, gjykata vendos revokimin e gjobës. Kundër vendimit për revokimin e gjobës nuk lejohet ankim.
5. Vendimi për caktimin e gjobës përbën titull ekzekutiv.
6. Gjkata njofton dhomën e avokatëve ose institucionin apo entin përkatës për ekspertët dhe përkthyesit për sjelljen e papërshtatshme.
7. Kur prokurori me veprimet e tij cenon rregullat e seancës gjyqësore, gjykata i tërheq vëmendjen dhe në rast përsëritje, njofton drejtuesin e prokurorisë.
8. Ndaj pjesëmarrësve të tjerë në gjykim që nuk zbatojnë urdhrat e kryetarit për ruajtjen e rendit e qetësisë apo fyejnë autoritetin e gjykatës, kryetari i paralajmëron ata dhe, kur nuk respektojnë urdhërimin e gjykatës, kryetari urdhëron largimin e tyre nga seanca dhe kur e çmon të nevojshme, u cakton gjobë deri në shumën 30 000 lekë."

Vendimi nr. 238/1/b, datë 24.12.2008 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë "Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit".

Neni 2

Vendi i zhvillimit të gjykimit

Të gjitha proceset gjyqësore, për sa është e mundur, duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete.

Çdo sallë gjykimi, ndër të tjera, duhet të jetë e pajisur me këto elemente tregues të solemnitetit gjyqësor:

- stemën e Republikës së Shqipërisë, e pozicionuar në pjesën e sipërme të murit që gjendet pas podiumit ku qëndron gjykata,
- flamurin kombëtar, i pozicionuar në anën e djathtë të sallës, në krah të podiumit ku qëndron gjykata,
- një barrierë prej druri ose materiali tjetër, që shërben si ndarje mes sipërfaqes së sallës ku qëndron publiku dhe pjesës së saj ku qëndrojnë subjektet pjesëmarrëse në gjykim.

Çdo sallë gjykimi, duhet të pajiset me një vend të posaçëm për qëndrimin e dëshmitarit, ekspertit dhe përkthyesit. Urdhër nr. 358, datë 5.9.2013 i Ministrit të Drejtësisë “Për tarifat e transkriptimit të procesverbalit të seancës gjyqësore të mbajtur me mjete të regjistrimit audio ose audioviziv”

1. Tarifat për transkriptimin e procesverbaleve të seancës gjyqësore, në rastet kur transkriptimi bëhet me kërkesë të palëve në gjykim ose personave të tjerë të interesuar, janë si më poshtë:


- a) Transkriptimi i një fragmenti nga procesverbali i seancës gjyqësore - 500 lekë;
 - b) Transkriptimi i një procesverbali të seancës gjyqësore - 1500 lekë.
2. Transkriptimi me kërkesë të trupit gjykues nuk i nënshtrohet tarifës.
 3. Palëve në gjykim ose personave të tjerë të interesuar u jepet transkriptimi i procesverbalit të seancës gjyqësore, vetëm pasi vërtetojnë pagimin e tarifës së transkriptimit.
 4. Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.

Urdhër Nr. 359, datë 5.9.2013 i Ministrit të Drejtësisë “Për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore apo të veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë Seance”

1. Procesverbali i seancës gjyqësore apo i veprimeve të tjera procedurale që zhvillohen jashtë seance, të mbajtura nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv apo në formën e një përmbledhjeje të saktë me shtypshkrim apo dorëshkrim, si pjesë përbërëse e dosjes gjyqësore, arkivohet dhe ruhet për aq kohë sa ruhet vetë dosja gjyqësore.
2. Rregullat për ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të mbajtur nëpërmjet regjistrimit audio ose audioviziv, përcaktohen në udhëzimin nr. 353, datë 3.9.2013 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio”.
3. Procesverbali i mbajtur në formën e një përmbledhjeje me shtypshkrim apo dorëshkrim ruhet në dosjen gjyqësore dhe arkivohet duke ndjekur rendin kronologjik të akteve në dosjen gjyqësore, në bazë të nënshkrimit të sekretares gjyqësore, si dhe me vulën e gjykatës. Atij mund t’i bashkëlidhen edhe shpjegimet dhe pretendimet me shkrim të paraqitura nga palët, në mbështetje të kërkesave dhe konkluzioneve të tyre, në përputhje me nenin 172 të Kodit të Procedurës Civile.
4. Palët, personat e tretë të thirrur në gjykatë, si dhe personat e interesuar mund të tërheqin kopje të procesverbaleve të arkivuara në dosje, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim kundrejt pagesës dhe me lejen e gjykatës në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 77 të Kodit të Procedurës Civile.
5. Në çdo rast, e drejta e palëve dhe e publikut për t’u njohur me dosjen gjyqësore përfshin edhe të drejtën për t’u njohur me procesverbalin e seancës gjyqësore.
6. Ngarkohen gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.

Shtojca 2


Përqindja e Përdorimit të Sistemit RDA në qershor 2016



Grupi i gjykatave	Kategoria sipas përqindjes	Gjykata	Nr. i gjykatave
1	Gjykata të cilat regjistrojnë më mjete audio 100% të seancave gjyqësore	Gjykata e Apelit Gjirokastrë	11
		Gjykata e Apelit Korçë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	
		Gjykata e Apelit Vlorë	
		Gjykata e Apelit për Krime të Rënda	
		Gjykata e Apelit Durrës	
		Gjykata e Apelit Tiranë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet	
		Gjykata e Apelit Shkodër	
2	Gjykata të cilat regjistrojnë më mjete audio mbi 90% të seancave gjyqësore	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	9
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë	
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë			
3	Gjykata të cilat regjistrojnë më mjete audio nën 90% të seancave gjyqësore	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	16
		Gjykata Administrative Tiranë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	
		Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin	
		Gjykata Administrative Shkodër	
		Gjykata Administrative Korçë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	
		Gjykata Administrative Vlorë	
		Gjykata Administrative Apelit Tiranë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	
		Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	
Gjykata Administrative Durrës			
4	Gjykata të cilat regjistrojnë më mjete audio por nuk kanë gjeneruar raporte	Gjykata Administrative Gjirokastrë	2
		Gjykata e Lartë	
Total			38

Shtojca 3

Formularët e përdorur në studim



FORMULAR 1

PYETËSOR PËR T'U PLOTËSUAR NGA MONITORUESI LIDHUR ME SEANCAT GJYQËSORE¹⁰

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të zbatimit të nismës “Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri”, mbështetur nga projekti i USAID-it Drejtësi për të gjithë. Kjo nismë zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Synimi i tij është të marrë të dhëna dhe të evidentojë problematika në lidhje me përdorimin e sallave të gjykimeve dhe përdorimin e regjistrimit audio në gjykata. Të dhënat e marra nëpërmjet tij do të jenë pjesë e një studimi mbarëkombëtar i cili do t'u paraqitet Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrit të Drejtësisë, me qëllim që të garantohet përdorimi maksimal i sistemit të regjistrimit audio dhe i sallave të gjykimeve për një transparencë të plotë të proceseve gjyqësore në vend. Me këtë hap synohet edhe rritja e besimit të qytetarëve tek gjykatat dhe sistemi i drejtësisë në tërësi.

Emri dhe Mbiemri i monitoruesit: _____

Data e monitorimit: _____

INFORMACION I PËRGJITHSHËM¹¹

Emri i Gjykatës	
Numri i sallave në përdorim (ku po mbahet një seancë) në momentin që mbërrin monitoruesi?	
A punon ky sistem në çdo sallë (dhomë) të gjykatës?	Po Jo
A punon sistemi audio në ambientin ku po zhvillohet seanca konkrete?	Po Jo

INFORMACION MBI SEANCËN QË PO MONITOROHET

1. Lloji i gjykimit që po monitorohet:

- Çështje civile e përgjithshme, Gjykim me palë kundërshtare
- Çështje familjare, Gjykim me palë kundërshtare
- Çështje tregtare, Gjykim civil me palë kundërshtare
- Çështje civile e përgjithshme, Gjykim pa palë kundërshtare (me një palë)
- Çështje familjare, Gjykim pa palë kundërshtare (me një palë)
- Çështje tregtare, Gjykim pa palë kundërshtare (me një palë)
- Gjykim penal;
- Gjykim administrativ;

¹⁰ Pyetjet janë bazuar në Udhëzimin Nr. 353, datë 3.9.2013 “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR MBAJTJEN, RUAJTJEN DHE ARKIVIMIN E PROCESVERBALIT TË SEANCËS GJYQËSORE ME MJETE AUDIO” të Ministrisë së Drejtësisë, mjetet digjitale audio të regjistrimit të seancave gjyqësore përdoren për regjistrimin e seancave gjyqësore të gjykimeve civile, administrative dhe penale, zhvilluara në ambientet e gjykatave ku zhvillohen seanca gjyqësore në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë.

¹¹ “Informacioni i përgjithshëm” plotësohet vetëm për seancën e parë që monitorohet.

2. A është kjo seanca e parë e këtij gjykimi?

- a. Po
- b. Jo

3. Në çfarë faze të çështjes po ndodh monitorimi?

- a. Fazë përgatitore
- b. Shqyrtim gjyqësor
- c. Konkluzione përfundimtare
- d. Vendimi përfundimtar

4. A po bëhet regjistrimi audio i seancës?

- a. Po
- b. Jo (Nëse Jo, kalo tek Pyetja Nr.13: Nëse nuk po bëhet regjistrimi audio i seancës, shpjegoni arsyen pse seanca nuk po regjistrohet)

5. Nëse po, a është siguruar sekretari gjyqësor, përpara se të nisë seanca, që palët dhe pjesëmarrësit e tjerë janë ulur në vendet përkatëse për të bërë të mundur regjistrimin audio?

- a. Po
- b. Jo (Nëse jo, ju lutem shpjegoni pse): _____
- c. Nuk e di (ju lutem shpjegoni): _____

6. Kur bëhet regjistrimi audio i seancës, a ka informuar kryetari i seancës, në fillim të seancës gjyqësore, të gjithë të pranishmit lidhur me regjistrimin?

- a. Po, rregullisht.
- b. Po, në disa raste.
- c. Jo
- d. Nuk e di (ju lutem shpjegoni): _____

7. A janë udhëzuar palët që të flasin qartë në mikrofon, të përgjigjen me fjalë dhe të shmangin gjestet ose lëvizjet e kokës pasi këto gjeste nuk mund të kapen nga regjistrimi?

- a. Po
- b. Jo

8. A ka patur raste kur u është tërhequr vëmendja palëve nga palet e tjera dhe kjo i është evidentuar kryetarit të seancës?

- a. Po
- b. Jo

9. A janë dëgjuar nga gjyqtari dëshmitarët, apo të pranishmit e tjerë në seancë me regjistrim audio?

- a. Po
- b. Jo

10. Nëse po, a po udhëzohen dëshmitarët që të flasin qartë, të përgjigjen me fjalë, në mikrofon?

- a. Po
- b. Jo

11. A po përpiqen gjyqtarët të shmangin diskutimet që bëhen në sfond në mënyrë që të mos pengohet regjistrimi audio?

- a. Po
- b. Jo

12. A është ndërprerë ndonjëherë regjistrimi gjatë seancës?

- a. Po
- b. Jo

12.1 Nëse po, përcaktoni cila ka qenë arsyeja si më poshtë:

- a. Gjatë seancës diskutohen çështje delikate që kanë të bëjnë me të miturit;
- b. Gjatë seancës diskutohen sekrete shtetërore;
- c. Gjatë seancës diskutohen të dhëna financiare të palëve;
- d. Gjatë seancës diskutohen çështje të sigurisë së dëshmitarëve;
- e. Gjatë seancës diskutohen çështje të sigurisë së të paditurve;
- f. Kur një gjë e tillë kërkohet nga palët dhe pranohet nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit procedural në fuqi;
- g. Ndërprerja e energjisë elektrike;
- gj. Tjetër, përshkruaj _____

13. Nëse nuk po bëhet regjistrimi audio i seancës, shpjegoni arsyen pse seanca nuk po regjistrohet?

- a. Pajisja e regjistrimit është e prishur
- b. Nuk ka energji elektrike
- c. Nuk ka asnjë sallë gjykimi të lirë
- d. Për arsye të tjera (specifiko) _____

14. Nëse seanca mbahet në zyrën e gjykatësit, a janë përjashtuar disa nga pjesëmarrësit (të pranishmit)?

- a. Po (specifiko, janë lënë jashtë sepse nuk ka hapësirë të mjaftueshme, apo arsye të tjera?)
- b. Jo
- c. Nuk e di (ju lutem shpjegoni) _____

15. Nëse seanca është mbajtur në zyrën e gjykatësit, a është ankuar ndonjë nga pjesëmarrësit se pse seanca është mbajtur në zyrën e gjykatësit dhe jo në sallë?

- a. Po
- b. Jo
- c. Nuk e di (ju lutem shpjegoni) _____

16. A ka patur ndonjë ankesë nga palët lidhur me përdorimin e sallave të gjyqimit?

- a. Po (shpjegoni) _____
- b. Jo

17. Është ngritur ndonjë ankesë nga palët lidhur me regjistrimin audio?

- a. Po (specifiko): _____
- b. Jo

Shënime të tjera:

Firma e monitoruesit _____

Data: _____

FORMULAR 2

PYETËSOR PËR PËRDORUESIT E GJYKATAVE

Shënime për vëzhguesin/ personin që bën intervistën

Duhet t'u bëni të qartë të intervistuarve qëllimin e kësaj interviste, kohëzgjatjen e saj dhe detaje të tjera lidhur me të:

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të zbatimit të nismës "Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri", mbështetur nga projekti i USAID-it Drejtësi për të gjithë. Kjo nismë zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Synimi i tij është të marrë të dhëna dhe të evidentojë problematika në lidhje me përdorimin e sallave të gjykimeve dhe përdorimin e regjistrimit audio në gjykata. Të dhënat e marra nëpërmjet tij do të jenë pjesë e një studimi mbarëkombëtar i cili do t'u paraqitet Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrit të Drejtësisë, me qëllim që të garantohet përdorimi maksimal i sistemit të regjistrimit audio dhe i sallave të gjykimeve për një transparencë të plotë të proceseve gjyqësore në vend. Me këtë hap synohet edhe rritja e besimit të qytetarëve tek gjykatat dhe sistemi i drejtësisë në tërësi.

Kjo interviste zgjat 10 minuta. Ruhet anonimati i të intervistuarit.

Duhet të kërkonti leje për përdorimin e citimeve në raportin final dhe nëse leja ju sigurohet duhet që të mban shënim dhënien e pëlqimit. (Formulari i dhënies së pëlqimit gjendet bashkëlidhur dhe i jepet personit që intervistohet)

1. Gjinia e të intervistuarit:

- a. Mashkull
- b. Femër

2. A është i intervistuari pjesë e një grupi etnik apo fetar të caktuar, person me aftësi të kufizuara (ose grupe të tjera vulnerabël) ?

- a. Po
- b. Jo

2.1 Nëse po, pjesë e cilit grup?

- a. Minoritet
- a. Komunitet fetar
- b. Viktimë e dhunës në familje
- c. Person me aftësi të kufizuara
- d. Tjetër, specifiko _____

3. Cili është roli (statusi) i personit që po intervistohet?

- a. Paditës
- b. I paditur
- c. Dëshmitar
- d. Ekspert
- e. I dëmtuar nga vepra penale
- f. Përfaqësues i institucionit shtetëror /jurist si palë në proces
- g. Prokuror
- h. Avokat (i caktuar nga shteti ose avokat privat)
- i. Tjetër, specifiko _____

4. Keni eksperiencë të mëparshme me regjistrimin audio?

- a. Po
- b. Jo

5. Keni qenë ndonjëherë prezent në një seancë e cila është regjistruar në audio?

- a. Po
- b. Jo

6. A janë regjistruar në audio të gjitha seancat të lidhura me çështjen/çështjet tuaj/a?

- a. Po
- b. Jo

7. Nëse keni qenë prezent në më shumë se një seancë, sa nga seancat ku ju keni qenë prezent janë regjistruar në audio?

- a. Asnjë
- b. Disa (pak)
- c. Shumë
- d. Të gjitha

8. Nga eksperiencia juaj në këtë gjykatë, çfarë lloj seancash janë regjistruar më shumë në audio?

- a. Civile
- b. Penale
- c. Administrative

9. Nëse keni qenë prezent si në seancat në sallë gjykimi ashtu edhe në ato të mbajtura në zyrë, mund të thoni nëse ka ndonjë ndryshim mes tyre? Ka ndryshime në sjelljen e palëve ose gjyqtarëve? Nëse po ju lutem shpjegoni _____

10. A keni qenë ndonjëherë prezent në një seance të mbajtur në zyrën e gjyqtarit ndërkohë që salla e gjykimit nuk po përdorej? Ishte e lirë (bosh)?

- a. Po
- b. Jo

10.1 Nëse po, shpjegoni arsyen pse seanca është mbajtur në zyrë? _____

11. A ju është kërkuar të dëshmoni ose të dëgjoheni në seancë?

- a. Po
- b. Jo

12. Nëse po, a jeni udhëzuar nga gjykata rreth përdorimit të mikrofonit dhe sistemit të regjistrimit audio, ose vendit ku të uleni dhe të flisni?

- a. Po
- b. Jo

13. Në dijeninë tuaj, a është ndërprerë ndonjëherë regjistrimi gjatë seancës?

- a. Po
- b. Jo

14. Nëse po, përcaktoni cila ka qenë arsyeja si më poshtë:

- a. gjatë seancës diskutohen çështje delikate që kanë të bëjnë me të miturit;
- b. gjatë seancës diskutohen sekrete shtetërore,
- c. gjatë seancës diskutohen të dhëna financiare të palëve
- d. gjatë seancës diskutohen çështje të sigurisë së dëshmitarëve
- e. gjatë seancës diskutohen çështje të sigurisë së të paditurve
- f. kur një gjë e tillë kërkohet nga palët dhe pranohet nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit procedural në fuqi
- g. ndërprerja e energjisë elektrike (dhe kjo ka qenë e shpeshtë)
- h. ndërprerja e energjisë elektrike (dhe kjo ka ndodhur rrallë)
- i. ndërprerja e energjisë elektrike (kjo ka ndodhur vetëm një herë)
- j. tjetër, përshkruaj _____

15. Keni kërkuar ndonjëherë kopje të regjistrimeve audio në gjykatë?

- a. Po
- b. Jo (Nëse "Jo", Kalo tek Pyetja 27)

16. Nëse po, e keni të qartë (e kuptoni) formularin që duhet plotësuar për kërkimin e kopjeve të regjistrimit audio?

- a. Po
- b. Jo

17. Nëse nuk e kuptoni formularin, ju lutem përcaktoni çfarë nuk keni të qartë

18. Nëse keni plotësuar formularin, ndonjë sugjerim për t'i bërë udhëzimet më të thjeshta në kuptim dhe përdorim?

19. Nëse keni drejtuar kërkesë, a e ka plotësuar gjykata kërkesën tuaj për marrje të kopjeve të regjistrimit audio?

- a. Po
- b. Jo

20. Nëse gjykata nuk e ka plotësuar kërkesën, ju lutem shpjegoni pse dhe përshkruani përgjigjen që ju ka dhënë gjykata. Ishte i arsyetuar vendimi i gjykatës? _____

21. Nëse po, (Gjykata i ka lëshuar këto kopje), a janë dhënë ato në kohë (24 orë pas pagesës për çështje me vendim përfundimtar, dhe 48 orë për çështje në gjykim)?

- a. Po
- b. Jo

22. Nëse Gjykata nuk jua dhënë në kohë, ju lutem shpjegoni pse dhe përshkruani përgjigjen e gjykatës)

23. Nëse keni kërkuar kopje të regjistrimit, keni pasur ndonjë pakënaqësi lidhur me koston financiare për marrjen e kopjes së regjistrimit audio?

- a. Po
- b. Jo

24. Nëse keni patur pakënaqësi, ju lutem shpjegoni, çfarë lloj pakënaqësie?

25. Nëse ju keni marrë një kopje të regjistrimit audio, keni patur vështirësi (probleme) lidhur me dëgjimin dhe të kuptuarin e regjistrimit?

- a. Po
- b. Jo

26. Nëse po, ku konsistonte problemi me CD-në e incizuar?

- a. CD-ja nuk hapej lehtësisht nga kompjuteri ose mjetet e tjera elektronike;
- b. Fjalët dhe fjalitë nuk dëgjoheshin;
- c. Tjetër (shpjegoni): _____

27. Ju lutem vlerësoni shërbimin e gjykatës lidhur me regjistrimin audio?

- a. I kënaqshëm
- b. I pakënaqshëm
- c. Nuk jam në gjendje ta vlerësoj

28. Sipas mendimit tuaj, cilat janë përfitimet e regjistrimit audio?

- a. Shmang keqkuptimet;
- b. Ndhmon në transparencën e veprimeve të ndërmarra nga gjykata dhe palët;
- c. Parandalon rastet e korrupsionit;
- d. Është më i saktë (korrekt) sesa shkrimi i dorës ose shkrimi në kompjuter;
- e. a, b, c dhe d;
- f. Tjetër (shpjegoni): _____

29. Sipas mendimit tuaj, cilat janë përfitimet e përdorimit të sallave të gjyqimit?

- a. Është më komode pasi ka më shumë vende për t'u ulur;
- b. Ndhmon në transparencën e veprimeve të ndërmarra nga gjykata ose palët;
- c. Parandalon rastet e korrupsionit;
- d. Është më serioz dhe profesional;
- e. a, b, c dhe d;
- f. Tjetër (shpjego): _____

30. Ndonjë koment tuajin që mund ta citojmë në raportet tona (bashkangjitur deklarata për dhënien e pëlqimit)?

Intervistuesi: _____

Data: _____

FORMULAR 3 PYETJE PËR KANCELARIN/EN

SHPJEGIME PËR PERSONAT E INTERVISTUAR NË GJYKATA

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të zbatimit të nismës "Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri", mbështetur nga projekti i USAID-it Drejtësi për të gjithë. Kjo nismë zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Synimi i tij është të marrë të dhëna dhe të evidentojë problematika në lidhje me përdorimin e sallave të gjykimeve dhe përdorimin e regjistrimit audio në gjykata. Të dhënat e marra nëpërmjet tij do të jenë pjesë e një studimi mbarëkombëtar i cili do t'u paraqitet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrit të Drejtësisë, me qëllim që të garantohet përdorimi maksimal i sistemit të regjistrimit audio dhe i sallave të gjyqit për një transparencë të plotë të proceseve gjyqësore në vend. Me këtë hap synohet edhe rritja e besimit të qytetarëve tek gjykatat dhe sistemi i drejtësisë në tërësi.

Kjo intervistë zgjat 15-20 minuta.

PYETJE PËR KANCELARIN/EN

EMRI I GJYKATËS _____

Pyetje për përdorimin e sallave

1. Sa salla gjykimi ndodhen në gjykatën tuaj? _____
2. Sa seanca zhvillohen në salla gjykimi dhe sa seanca në zyrat e gjyqtarëve?
 - a) 100%, të gjitha në sallë gjyqi
 - b) më shumë se 70% zhvillohen në salla gjyqi
 - c) më shumë se 50% (gjysma e seancave) zhvillohen në salla gjyqi
 - d) një pjesë e vogël (5-10%) zhvillohen në zyrën e gjyqtarit
 - e) tjetër, specifiko _____
3. Cilat seanca zhvillohen më tepër apo më shpesh në sallë gjykimi?
 - a) Seanca përgatitore
 - b) Seanca gjyqësore civile
 - c) Seanca gjyqësore penale
 - d) Seanca masë sigurimi
 - e) Çdo lloj seance
4. A ka problematika në lidhje me sallat e gjykimit dhe përdorimin e tyre?
 - a) Po
 - b) Jo

Nëse po specifiko: _____

Pyetje për regjistrimin audio

5. Kur seanca regjistrohet në audio, ka ofruar gjykata mbështetjen e personelit ndihmës në gjykatë për kryerjen e funksionit të regjistrimit audio nga sekretari gjyqësor?
 - a) Po (Specifiko pozicionin e stafit që kryen mbështetjen dhe a mundet t'i mbulojë nevojat për mbështetje _____)
 - b) Jo

6. A ka patur raste kur regjistrimi audio i seancës gjyqësore është i pamundur të realizohet, për shkak të defekteve në pajisje?

- a) Shpesh
- b) Rrallë
- c) Vetëm një herë
- d) Asnjëherë

Nëse ka patur raste a mundet të specifikoni arsyen pse ka ndodhur:

7. Nëse ka patur defekte, si keni vepruar në këtë rast?

8. Në dijeninë tuaj, a është ndërprerë ndonjëherë regjistrimi gjatë seancës? Nëse po, përcaktoni cila ka qenë arsyeja si më poshtë:

- a. gjatë seancës diskutohen çështje delikate që kanë të bëjnë me të miturit;
- b. gjatë seancës diskutohen sekrete shtetërore,
- c. gjatë seancës diskutohen të dhëna financiare të palëve
- d. gjatë seancës diskutohen çështje të sigurisë së dëshmitarëve
- e. gjatë seancës diskutohen çështje të sigurisë së të paditurve
- f. kur një gjë e tillë kërkohet nga palët dhe pranohet nga gjykata me vendim të arsyetuar të saj, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit procedural në fuqi
- g. ndërprerja e energjisë elektrike (nëse kjo ka ndodhur, a janë të shpeshta këto ndërprerje në gjykatën tuaj Po/Jo)
- h. tjetër, përshkruaj _____

Pyetje për marrjen e kopjeve të CD-ve dhe transkriptimeve

9. A ka patur kërkesa nga palët për kopje të regjistrimit audio në CD që nga vendosja e regjistrimit audio?

- a) Shumë
- b) Rregullisht
- c) Disa
- d) Pak
- e) Tjetër, specifikoj _____

10. A janë lëshuar kopje të vërtetuara të regjistrimit origjinal, në formë të pamodifikueshme, në CD-të e paraqitura paraprakisht nga palët pas pagesës së plotë të tarifës përkatëse?

- a) Po
- b) Jo

11. Nëse po, sa ka qenë afërsisht numri i këtyre kërkesave që nga vendosja e regjistrimit audio? _____

12. Sa ka qenë afërsisht numri i këtyre kërkesave gjatë vitit të fundit (shtator 2015-shtator 2016)? _____

13. Nëse jo (nuk janë lëshuar kopjet), cili ka qenë arsyetimi i gjykatës?

14. A janë lëshuar këto kopje në kohë (24 orë pas pagesës për çështje me vendim përfundimtar, dhe 48 orë për çështje në gjykim)?

- a) Po
- b) Jo

15. Për cilat lloje çështjesh janë kërkuar ato?

- a) Civile
- b) Penale
- c) Administrative
- d) Tjetër _____

16. A ka patur ankesa në lidhje me vonesa në dorëzim?

- a) Po
- b) Jo

17. Nëse po, sa ka qenë afërsisht numri i ankesave të depozituara? _____

18. A kanë ngritur palët ndonjë pretendim në lidhje me qartësinë apo kuptueshmërinë e regjistrimit audio në CD-në?

- a) Po
- b) Jo

19. Nëse po, cili ishte problemi?

- a. Regjistrimi nuk ishte i dëgjueshëm (zëri i ulët apo shumë zhurmë në sfond)
- b. Fjalë apo fjali nuk kuptoheshin
- c. Mungonte ndonjë pjesë nga ato që ishin thënë në seancë
- d. Tjetër (sqaro)

20. A kanë ngritur palët ndonjë pretendim në lidhje pagesën e tarifës për marrjen e kopjes së regjistrimit audio?

- a. Po
- b. Jo

21. A ka patur kërkesa për transkriptim të seancave të regjistruara me audio?

- a. Po
- b. Jo

22. Nëse po, sa ka qenë afërsisht numri i kërkesave të depozituara? _____

23. A janë vënë në dispozicion transkriptimet kur ato janë kërkuar nga palët e interesuara?

- a) Po
- b) Jo

24. Nëse jo, cila ka qenë arsyeja (shkurtimisht)

25. A është evidentuar ndonjë problematikë përse i përket kryerjes së funksionit të transkriptimit?

26. A është ngritur ndonjë pretendim në lidhje me saktësinë e transkriptimeve?

- a) Po (Specifiko _____)
- b) Jo

27. Nëse po, cili ishte problemi i evidentuar?

- a. Nuk ishin te lexueshme
- b. Mungonte ndonjë pjesë
- c. Tjetër (sqaro)

Pyetje për kuadrin ligjor

28. A ka ndonjë pengesë ligjore apo boshllëk ligjor e/i cila/i krijon problematikë në përmbushjen e detyrave dhe funksionit të sekretarit gjyqësor në kuadër të regjistrimit audio?

29. A ka ndonjë pengesë ligjore apo boshllëk ligjor e/i cila/i krijon problematikë në përmbushjen e detyrave dhe funksionit të kancelarit në kuadër të regjistrimit audio?

30. A keni evidentuar ndonjë problematikë në zbatim të Udhëzimit të Ministrit Nr. 353, datë 3.9.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e procesverbalit të seancës gjyqësore me mjete audio"?

31. Ndonjë problematikë me raportimin periodik me shkrim pranë Ministrit të Drejtësisë për ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi në gjykatë?

Pyetje të përgjithshme

32. Cilat janë, sipas jush, përfitimet e regjistrimit audio?

33. A keni ndonjë sugjerim për ta përmirësuar funksionin e kancelarit, sekretarit gjyqësor apo stafit IT në lidhje me regjistrimin audio?

34. Komente të tjera _____

35. Ndonjë koment tuajin që mund ta citojmë në raportet tona (bashkangjitur deklarata për dhënien e pëlqimit)?

FORMULAR 4

SHPJEGIME PËR PERSONAT E INTERVISTUAR

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të zbatimit të nismës “Të punojmë së bashku për seanca gjyqësore të hapura dhe transparente në gjykatat e të gjitha niveleve në Shqipëri”, mbështetur nga projekti i USAID-it Drejtësi për të gjithë. Kjo nismë zbatohet nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

